

INFOSTAT



REVISTË INFORMATIVE

NR. 04



INFOSTAT



REVISTË INFORMATIVE

NR. 04

INFOSTAT 04

Drejtor botimi: **Dr. Elsa Dhuli**

Bordi Editorial

1. Helda Curma, Instituti i statistikave
2. Elona Sevrani, Instituti i Statistikave
3. Altin Xhikneli, Instituti i Statistikave
4. Erjola Gjika, Instituti i Statistikeve
5. Dr. Liljana Boçi, Instituti i Statistikave
6. Ilirjana Kraja, Instituti i Statistikave

Kordinator: Enkelejt Avdyli, Instituti i Statistikave

© Copyright INSTAT 2024

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta,

Ndërtesa 35, Hyrja 1

Tiranë, Kodi Postar 1017

Tel: + 355 4 2222411 / 2233356

Fax: +355 4 2222 411

e-mail: info@instat.gov.al

www.instat.gov.al

Design: Gentian Suçi

P Ë R M B A J T J A

Faqe 7	Instrumentat monitoruese për zbatimin e rekomandimeve Evropiane
Ndryshimet midis IÇK dhe IHÇK. Rasti i Shqipërisë	Faqe 15
Faqe 25	Përdorimi i burimeve administrative në vlerësimet e statistikave afatshkurtra
Ngjarjet demografike të bizneseve në Shqipëri	Faqe 33
Faqe 41	TIK dhe digjitalizimi
Ecuria e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në Shqipëri	Faqe 47

INSTRUMENTAT MONITORUESE PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE EVROPIANE

IRZA RROJI¹

SILVANA SHEHU²

GRESJANA DERVISHI³

Abstrakt

Sistemi Kombëtar Statistikor i është nënshtruar procesit të vazhdueshëm të vlerësimit nga partnerët evropianë në lidhje me nivelin e përputhshmërisë me legjislacionin përkatës në fushën e statistikave zyrtare. Procesi i vlerësimit të përputhshmërisë është realizuar me anë të monitorimit të zbatimit së *acquis communautaire* të Kapitullit 18 “Statistikat” si dhe ecurinë e koordinimit dhe respektimin e parimeve statistikore. Progres raportet e BE-së për integrimin Evropian, raportet mbi zbatimin e rekomandimeve të Peer Review, vlerësimet sipas SMIS+ dhe raportet e Eurostat mbi atë që Shqipëria transmeton në Eurostat shërbejnë si instrumenta monitoruese për zbatimin e rekomandimeve evropiane. Nga ana tjetër, raportet kanë shërbyer për orientimin strategjik dhe operacional të institucioneve shqiptare, prodhuese të statistikave zyrtare, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të performancës dhe cilësisë së produktit statistikor. INSTAT-i, si koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor, për secilën fushë të monitoruar nga Eurostat, harton çdo vit një plan konkret me aktivitete zbatuese/përmirësuese, shoqëruar me strukturat përgjegjëse dhe afatet e përcaktuara për realizimin e këtyre aktiviteteve, plane të cilat monitorohen dhe raportohen në nivel 4-mujor dhe vjetor.

Fjalë kyçe:

Sistemi Kombëtar Statistikor, Integrimi Evropian, Kapitulli 18, Peer Review, SMIS +, Data points.

1. Instituti i Statistikave irroji@instat.gov.al

2. Instituti i Statistikave sshehu@instat.gov.al

3. Instituti i Statistikave gdervishi@instat.gov.al

1. HYRJJE

Instituti i Statistikave si koordinator i prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare në vend, synon rritjen e gamës së produkteve statistikore, zhvillimin e kapaciteteve, ruatjen e vlerave të statistikave zyrtare dhe cilësinë e tyre, duke i konsideruar si një e mirë publike në shërbim të politikbërësve, kërkuesve shkencorë dhe komunitetit. Për këtë, INSTAT punon në mënyrë të vazhdueshme dhe intensive për rritjen e nivelit të përputhshmërisë së procedurave statistikore me rregulloret evropiane. Për të patur një orientim më të drejtë dhe të matshëm në arritjen e këtyre synimeve, INSTAT dhe Sistemi Kombëtar në tërësi përdorin instrumentet dhe dokumentet evropiane të monitorimit, të cilat janë:

1. Progres Raportet periodike të BE-së për Shqipërinë, veçanërisht për Kapitullin 18 “Statistikat”;
2. Raporti “Peer Review” dhe Rekomandimet për zbatimin e tyre;
3. Sistemin SMIS+, si instrument monitorimi për vetvlerësimin e përputhshmërisë me kërkesat e Eurostatit;
4. Vlerat “data points” të identifikuar si indikator performance në lidhje me sasinë e të dhënave të dërguara nga Sistemi Kombëtar Statistikor dhe të pranuar nga Eurostat.

Orientim mjaft i vlefshëm në këtë drejtim janë rekomandimet e dhëna nëpërmjet raporteve Peer Review që kryejnë ekipet e ngarkuara nga Eurostat për vlerësimin e Sistemeve Kombëtare Statistikore të shteteve anëtare dhe vendeve që synojnë integrimin evropian.

2. PROGRES-RAPORTET E INTEGRIMIT EVROPIAN PËR KAPITULLIN 18 “STATISTIKAT”

Hapja zyrtare e negociatave të anëtarësimit me BE-në e ktheu Shqipërinë zyrtarisht në një vend negociues, një hap më pranë anëtarësimit dhe një hap cilësor në bashkëpunimin me BE-në. Hapja e negociatave përmbushi një nga objektivat kryesorë të programit të qeverisë shqiptare. Konferenca e parë Ndërqeveritare, e cila u zhvillua më datë 19 korrik 2022 dhe paralelisht me të u zhvillua një takim formal me të cilin Komisioni, bazuar në mandatin e Këshillit të marsit 2020, nisi formalisht procesin e shqyrtimit analitik të *acquis* (*screening*).

Shqyrtimi analitik i ligjeve të BE-së (*acquis*), i ashtuquajtur “*Screening*”, u mundëson vendeve kandidate të familjarizohen me ligjet dhe standardet e BE-së dhe detyrimet që ato sjellin. Screening është hapi i parë në procesin e negociatave të anëtarësimit i cili përbëhet nga dy faza:

- 1) takimi shpjegues ku departamentet e Komisionit shpjegojnë kapitull pas kapitull *acquis* të BE-së.
- 2) takimi bilateral ku çdo vend kandidat është i ftuar të prezantojë situatën aktuale në përgatitjet për adoptim dhe zbatim të *acquite*.

INSTAT së bashku me agjencitë statistikore zhvilluan takimin dypalësh ku prezantuan se ku qëndrojnë, sipas kapitullit 18 “Statistikat”, në përgatitjet e tij për miratimin dhe zbatimin e *acquis*. Njësitë e Eurostat paraqitën përditësimet për çdo fushë statistikore ku legjislacioni është ndryshuar. Sipas raportit më të fundit të BE-së, Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në përafrimin e Statistikave me standardet e BE-së, veçanërisht në fusha të tilla si infrastruktura statistikore, Ligji nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare icili është në përputhje me rregulloren 223/09 mbi Statistikat Evropiane, Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane dhe shumica e klasifikimeve janë në përputhje me standardet e BE-së. Programi i statistikave zyrtare 2022-2026 po zbatohet sikurse parashikuar. Plani Vjetor 2024 i cili pritet të miratohet brenda vitit 2023, është në përputhje me dokumentin e ngjashëm, i cili aplikohet nga vendet e tjera anëtare të BE-së, mbështetur në nenin 17 të Rregullores (KE) 223/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009 “Mbi statistikave evropiane”.

Rekomandimet e Progres Raportit për vitin 2023 dhe rekomandimet e Këshillit të Punëve Ekonomike dhe Financiare (ECOFIN) theksojnë shpërndarjen sikurse parashikuar të rezultateve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, si dhe përgatitjen e një plani të përditësuar të aktiviteteve dhe buxhetit për Censin e Bujqësisë, sigurimi për realizimin e tij në përputhje me *acquis* përkatëse të BE-së dhe standardet ndërkombëtare; marrja e masave për reduktimin e qarkullimit të stafit të Institutit të Statistikave (INSTAT), si dhe prodhimin dhe transmetimin e të dhënave në kohë dhe me cilësi të lartë në Eurostat, në veçanti të prodhojë statistikën financiare të qeverisë (GFS), dhe të dhënat të bëhen të disponueshme publikisht.

Në kuadër të këtyre rekomandimeve, INSTAT përfshiu datën e Censit të popullsisë dhe banesave në Planin vjetor 2023, për zbatimin e programit të Statistikave, PSZ, i cili u miratua në parlament në Janar 2023. Gjithashtu, INSTAT ka bërë disa përpjekje për të plotësuar vendet vakante dhe synon të rrisë nivelet e personelit nga 236 punonjës në 266 deri në vitin 2026, duhen përpjekje të tjera për të zvogëluar lëvizjet e stafit, për të siguruar që nevojat e prodhimit janë të mbuluara, dhe për të trajnuar personelin e ri në zhvillimet statistikore më të fundit.

INSTAT po vijon punën për të zhvilluar në kohë dhe me sukses Censin e Bujqësisë, i cili pritet të zhvillohet brenda vitit 2024. Në të njëjtën kohë po punohet me finalizimin e aspekteve metodologjike (nënshkrimi i Marrëveshjeve të Mirëkuptimit me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, draftimi i pyetësorit i cili është në fazë konsultimi me ekspertizën e FAO, dhe finalizimi i dokumentave strategjikë të këtij aktiviteti). Ligji i Censit të Ekonomive Bujqësore është draftuar, për të siguruar përafrimin me rregulloren EC 1091/2018 mbi Statistikat e Integruara të Fermave.

Progres është bërë në përshtatjen e mëtejshme me standardet e ESA 2010, janë përmirësuar afatet e publikimit të statistikave, dhe ka pasur një rritje në transmetimin e të dhënave në Eurostat. INSTAT po punon në drejtim të rritjes së përputhshmërisë së kuadrit ligjor, si dhe të intensifikimit të bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim përmirësimin e përpilimit të Statistikave Financiare të Qeverisë dhe tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar sipas standardeve Evropiane.

3. REKOMANDIMET PEER REVIEW DHE RAPORTET PERIODIKE PËR ZBATIMIN E TYRE

*Peer Review*⁴ është procesi i vlerësimit të përputhshmërinë së proceseve dhe akteve legjislative të vendeve anëtare, atyre kandidate dhe kandidate potenciale me parimet dhe treguesit e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane. Rekomandimet e lëna nga ekipet eksperte Peer Review ndihmojnë autoritetet statistikore për të përmirësuar më tej sistemet e tyre në zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare.

Ky proces synon të ndihmojë përmirësimin e mëtejshëm të performancës së zyrave kombëtare statistikore dhe agjencive statistikore duke përcaktuar rekomandimet e orientuara në këtë drejtim, si dhe të nxisë autoritetet e tjera shtetërore të mbështesin zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Peer Review fillon me shqyrtimin e përputhshmërisë së proceseve dhe standardeve të zyrave kombëtare statistikore dhe agjencive statistikore me parimet e Kodit të Praktikës, nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vetë-vlerësimit nga zyra apo agjencia statistikore subjekt i Peer review. Ky pyetësor është i ndërtuar nëpërmjet pyetjeve dhe ka si qëllim krahasimin e situatës faktike të proceseve dhe standardeve me treguesit e Kodit të Praktikës. Në fund të secilit modul të pyetjeve, për një parim të kodit ngrihen pyetje mbi fuqitë dhe dobësitë e institucionit në drejtim të zbatimit

4. *Vlerësimi i punës shkencore, akademike apo profesionale nga grupe të tjera të së njëjtës fushë pune (marrë nga fjalori i Oxford).

të këtij parimi, mbi aksionet inovative që institucioni gjykon të ndërmarrë për zbatim efektiv të parimit, si dhe aktivitetet që duhet të ndjekë dhe zbatojë institucioni për përmbushjen e plotë të kërkesave që rrjedhin nga ky parim.

Me tej procesi vijon me ngritjen e ekipit të ekspertëve të Peer review, organizimin e vizitës së ekipit në zyrën/agjencinë statistikore subjekt i këtij procesi, hartimin e raportit mbi situatën aktuale të proceseve, standardeve dhe legjislacionit mbi të cilat zyra statistikore ushtron veprimtarinë, si dhe hartimin e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme në drejtim të zbatimit të parimeve të kodit të praktikës.

Rekomandimet e lëna nga ekipi i ekspertëve Peer Review konkretizohen nga zyra statistikore në aktivitete zbatuese/përmirësuese, shoqëruar me afatet përkatëse. Bazuar në këtë plan aktiviteteve, Eurostat përgatit pyetësorin vjetor për matjen e realizueshmërisë së këtyre aktiviteteve, si instrumenti kryesor për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.

Procesi i fundit “Peer Review” u zhvillua në Qershor të vitit 2018. Nga ky proces dolën 24 rekomandime kanalizuar në 3 shtyllat si: I. *Forcimit të Mjedisit Institucional*, II. *Zhvillimit të mëtejshëm të menaxhimit të cilësisë dhe përmirësimit të raportit kosto-efektivitet*, III. *Përmirësimit të komunikimit me përdoruesit dhe aktorët e tjerë*, ku ndër më kryesoret mund të veçojmë rekomandimet për:

- Ngritjen e Komitetit të Prodhuesve, Komitetit të Cilësisë, Komisionit të Konfidencialitetit;
- Shtimin e përdorimit të metodave moderne IT në procesin e grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave;
- Planifikimin e hapave të zbatimit për harmonizimin e proceseve statistikore në drejtim të *GSBPM*;
- Vlerësimin e kostove të proceseve dhe produkteve statistikore duke mbajtur në konsideratë raportin kosto-efektivitet;
- Rritjen e vizibilitetit të Këshillit të Statistikave në publik;
- Intensifikimin e komunikimit me përdoruesit dhe bashkëpunimit me botën akademike.

Për zbatimin e këtyre rekomandimeve INSTAT vendosi 53 aktivitete zbatuese/përmirësuese, të cilat kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e performancës së Sistemit Kombëtar Statistikor.

Gjatë periudhës 2018-2023 nga aksionet e ndërmarra për realizimin e aktiviteteve përmirësuese janë arritur një sërë rezultatesh, ku në drejtim të forcimit të mjedisit institucional veçohen arritjet si krijimi i organizmave:

- a. Komiteti i Prodhuesve si organizëm i ngritur për forcimin e veprimtarisë koordinuese dhe bashkëpunuese brenda Sistemit Kombëtar Statistikor;
- b. Komiteti i Konfidencialitetit si organizëm kryesor për mbrojtjen e parimit të konfidencialitetit të të dhënave;
- c. Komiteti i Cilësisë si njësi përgjegjëse për nxjerrjen e udhëzimeve mbi cilësinë statistikore dhe raportet e cilësisë.

Në drejtim të forcimit të mëtejshëm të Sistemit Kombëtar Statistikor vlen për tu theksuar dhe krijimi i portalit të përbashkët për shpërndarjen e statistikave që prodhohen nga institucionet anëtare të sistemit.

Përsa i përket përpjekjeve të INSTAT-it për zhvillimin e mëtejshëm të menaxhimit të cilësisë dhe përmirësimit të raportit kosto-efektivitet vlen për tu theksuar hartimi i udhëzimeve të metodologjisë për të gjithë produktet statistikore, pilotimi dhe vënia në zbatim e metodës CAPI (mbledhja e të dhënave me kompjuter) për disa aktivitete statistikore, si përpjekje drejt modernizimit gjithnjë e më shumë të metodave të mbledhjes së të dhënave.

Ndërkohë, në drejtim të përmirësimit të komunikimit me përdoruesit dhe aktorët e tjerë vlen për t'u theksuar forcimi i bashkëpunimit me botën akademike, në kuadër të të cilit, INSTAT inicioi nismën për krijimin e Grupit Akademik me përfaqësues të INSTAT dhe universiteteve publike dhe private. Ky grup zhvilloi mbledhjen e tij të parë në Shkurt të vitit 2020, ku u prezantua qëllimi kryesor i këtij organizmi, si dhe objektivat që do të kishte në vazhdim ky grup. Më tej, në vitin 2021 u organizua webinar i me universitetet. Një tjetër takim u zhvillua në Shtator 2023 me temë “Takim informativ mbi Censin e Popullsisë dhe Banesave”. Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me disa universitete, gjatë vitit 2023, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT zhvilloi leksione të hapura me temë “Arritjet dhe sfidat e Cens-it 2023”, me universitetet si: Universiteti Europian i Tiranës, POLIS dhe Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë.

Grupi i botës akademike synon të vijojë më tej bashkëpunimin konstruktiv në modernizimin e metodave të prodhimit statistikor dhe kontributin e përbashkët në hartimin e artikujve shkencorë si një urë lidhëse midis nevojave të INSTAT për ekspertizën akademike dhe nevojave të akademikëve për të dhënat që INSTAT nxjerr, si mekanizmi kryesor për të çuar më tej studimet e tyre bazuar në të dhënat zyrtare.

Rekomandimet e raportit Peer Review të vitit 2018 pothuajse janë zbatuar plotësisht. Nga 24 rekomandime, janë realizuar 22 prej tyre dhe nga 53 aktivitete zbatuese janë realizuar 46 të tilla. Ndërkohë vazhdon zbatimi i rekomandimeve që nuk kanë afat përmbushje pasi janë të karakterit të vazhdueshëm dhe lidhen me raportimin vjetor të progresit lidhur me zhvillimin e teknikave elektronike, si dhe përdorimin e tyre; zbatimin e metodave të standardizuara për prodhimin e statistikave. Gjithashtu, aktivitet në realizim të vazhdueshëm është rritja e bashkëpunimit me botën akademike.

Procesi i raundit të tretë të Peer Review për vendin tonë pritet të zhvillohet në vitin 2025. Nga raportet Peer Review të publikuara për vendet anëtare të BE-së dhe EFTA, shumica e rekomandimeve lidhen me pavarësinë profesionale, koordinimin dhe bashkëpunimin, mandatin për mbledhjen e të dhënave, përshtatshmërinë e burimeve, paanshmërinë dhe objektivitetin, aksesin në të dhëna dhe qartësinë.

Një nga risitë e parashikuara për raundin e tretë të Peer Review është rishikimi i Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane (CoP)

4. RAPORTET E NIVELIT TË PËRPUTHSHMËRISË ME ACQUIS SIPAS SMIS +

Eurostat kryen vlerësimet vjetore të përputhshmërisë së statistikave me *acquis* për vendet candidate dhe candidate potenciale. Për realizimin e këtij ushtrimi Eurostat ka zhvilluar Sistemin e Informacionit për Menaxhimin Statistikor (SMIS+).


Procesi i monitorimit dhe vlerësimit të përputhshmërisë së statistikave me *acquis* fillon pas publikimit të “Statistical Requirements Compendium”⁶ nga Eurostat. Ky dokument hartohet nga Eurostat dhe përbën bazën kryesore referenciale për prodhimin e statistikave evropiane në përputhje me *acquis*. Dokumenti përmban një përshkrim të përmbledhur për çdo fushë statistikore, shoqëruar me informacion mbi bazën ligjore përkatëse, metodologjinë e prodhimit të statistikave të parashikuara në dokument, kërkesat për transmetimin e këtyre të dhënave, si dhe informacion mbi bashkëpunimin ndërkombëtar për çdo fushë statistikore. Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është të sigurojë një klasifikim standard të fushave statistikore, si dhe të të dhënave statistikore në brendësi të tyre, si dhe

6. Statistical Requirements Compendium është një përmbledhje në nivel vjetor mbi bazën referenciale të prodhimit të statistikave sipas *acquis*.

të garantojë krahasueshmëri e të dhënave ndërmjet vendeve. Përmbajtja e Statistical Requirements Compendium shërben si bazë për popullimin e sistemit “metadata-handler” që Eurostat përdor për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit. Ky sistem ka dy seksione: një seksion për popullimin me informacion nga Eurostat dhe një seksion për popullimin në formën e vetëvlerësimit nga zyrat statistikore. Informacioni i hedhur në sistem i kalon njësive të Eurostatit sipas temave statistikore për të cilat janë përgjegjëse dhe pas vlerësimit të nivelit të përputhshmërisë së aktiviteteve statistikore me rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian, Eurostat harton një raport vlerësimi sipas niveleve: *i paaplikueshëm; i papërputhshëm; i ulët; i mesëm; i lartë; Plotësisht në përputhje me acquis*.

Sipas raportit të fundit SMIS+ për vitin 2022, numri i aktiviteteve/produkteve statistikore sipas nivelit të përputhshmërisë me acquis rezulton të jetë si në figurën e mëposhtme:

Figura 1 “Niveli i Përputhshmërisë me Acquis Communautaire”, (bazuar në raportet e Eurostat mbi Përputhshmërinë e aktiviteteve me Acquis Communautaire, 2022).



Burimi: Raporti i Eurostat mbi nivelin e përputhshmërisë së aktiviteteve me acquis viti 2022.

Nga ky raport rezulton që janë të një niveli të lartë përafrimi statistikave të investimeve të huaja direkte, klasifikimet për prodhimin e tregtisë së jashtme të mallrave, klasifikimi NUTS, matja e fuqisë blerëse, statistikave mbi nivelin e jetesës, statistikave të turizmit, etj.

Aktivitetet statistikore me përputhshmëri të ulët i përkasin kryesisht fushës së Statistikave Sektoriale dhe fushës së Statistikave të Mjedisit, si: statistikave të blegtorisë, statistikave të çmimeve bujqësore, statistikave të eksport/import, statistikave të tregtisë së jashtme të shërbimeve, statistikave të inovacionit, statistikave mbi pesticidet, statistikave mbi mbetjet etj. Në këtë kontekst, Sistemi kombëtar statistikor bën përpjekje të vazhdueshme për përafrimin gjithnjë e më shumë të nivelit të përputhshmërisë së statistikave me *acquis* duke synuar implementimin e rregulloreve përkatëse. Konkretisht, një ndër objektivat kryesorë strategjik të Sistemit Kombëtar Statistikor është “Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht *acquis communautaire* lidhur me statistikave dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritetit Evropian”. Për arritjenë këtij objekti synohet përafrimi gjithnjë e më shumë i akteve ligjore me *acquis*, zbatimi i rekomandimeve të Eurostat në këtë drejtim, prodhimi i indikatorëve sipas specifikimeve të Eurostat, si dhe shtimi i numrit të të dhënave (data point) të transmetuara.


5. RAPORTET MBI DATA POINTS

Një tjetër instrument për monitorimin e gamës dhe serive kohore të statistikave që Sistemi Kombëtar Statistikor prodhon është databaza e Eurostat, e cila shërben dhe si një inventar për verifikimin dhe monitorimin e nivelit të plotësimit të kërkesave për të dhëna sipas indikatorëve të kërkuar. Nga llogaritjet vjetore të të dhënave që Shqipëria transmeton, Eurostat harton një raport vjetor mbi points (llogaritja në pikë) sipas temave statistikore të paracaktuara. Data point është vlera që përfaqëson të dhënë e një qelize në databazë. Trendi i vlerësimit në data points varet edhe nga ndryshimet strukturore të Eurostat në tabelat e transmetimit dhe publikimit të të dhënave. Duhet theksuar që në databazën e Eurostat nuk përfshihen të gjithë indikatorët që Sistemi Kombëtar Statistikor prodhon dhe jo të gjithë të dhënat që Sistemi transmeton. Gjithashtu, duhet patur parasysh që një e dhënë e transmetuar mund të përdoret nga Eurostat për prodhimin e disa indikatorëve të tjerë, duke sjellë dublikim të numrit të data points.

Po të shikojmë progresin e Shqipërisë ndër vite vihet re një rritje e konsiderueshme e numrit të të dhënave që Sistemi transmeton në Eurostat, ku në 5 vitet e fundit kjo vlerë ka shënuar një rritje prej 3.568.668 pikë, në Janar të vitit 2018 kjo vlerë ishte 1.010.625 ndërsa në Janar të vitit 2023 numri i data point për Shqipërinë ishte 4.579.293.

Në figurën e mëposhtme paraqitet progresi i Shqipërisë në përqindje në harkun kohor 5 vjeçar në drejtim të numrit të të dhënave të transmetuara në Eurostat:

Figura 2 “Ecuria e progresit të data point për Shqipërinë 2018-2023”, (bazuar në raportet e Eurostat mbi data point 2018 – 2023).



Burimi: Raportet e Eurostat mbi datapoint 2018-2023

6. KONKLUSIONE

Në procesin e përafrimit të prodhimit të statistikave me *acquis* përkatëse Sistemi statistikor Kombëtar ka ndjekur rekomandimet evropiane, zbatimi i të cilave është ndjekur nëpërmjet instrumentave monitoruese si: progress raportet e integritetit evropian, progress-raportet e zbatimit të Peer review, raportet e SMIS+ dhe raportet mbi data points.

Rezultatet e këtyre raporteve kanë shërbyer si platformë për ndërmarrjen e nismave për përmirësime të mëtejshme në kuadër të përafrimit të prodhimit statistikor me *acquis*, për prodhimin e treguesve sipas specifikimeve të Eurostat, shtimin e gamës së treguesve sipas kërkesave të Eurostat, si dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së SKS në drejtim të forcimit të mjedisit insticional, përmirësimin të raportit kosto-efektivitet, si dhe përmirësimin të komunikimit me përdoruesit dhe botën akademike.

Nga raportet e zbatimit të rekomandimeve INSTAT dhe agjencitë statistikore rezultojnë me një trend pozitiv në përafrimin e legjislacionit me *acquis*, si dhe në forcimin e vetë mjedisit institucional të sistemit, ku në zbatim të rekomandimeve të Peer Review u krijuan dhe organizmat si: Komiteti i Prodhuesve, Komiteti i Konfidencialitetit dhe Komiteti i Cilësisë. Gjithashtu në 5 vitet e fundit është rritur ndjeshëm numri i treguesve të transmetuara në Eurostat, duke plotësuar gjithnjë e më shumë kërkesat sipas prioriteve dhe kërkesave të Eurostat.

Në këtë kontekst, INSTAT vazhdon përpjekjet drejt progresit të vlerave të indikatorëve të performancës në kuadër të procesit të Integritetit Evropian si dhe proceseve të tjera parësore për harmonizimin dhe rritjen e nivelit të krahasueshmërisë së statistikave me statistikave e vendeve evropiane.

REFERENCA

1. ROUNDI I TRETË I PEER REVIEW (2021-2023)
<https://ec.europa.eu/eurostat/web/quality/peer-reviews/current-round-2021-2023>
2. RAPORTI PEER REVIEW – INSTAT
<https://www.instat.gov.al/al/sistemi-komb%C3%ABtar-statistikor/raporti-peer-review/>
3. RAPORTET E EUROSTAT MBI PËRPUTHSHMËRINË E AKTIVITETEVE ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE 2022
4. RAPORTET E EUROSTAT MBI DATA POINT PËR SHQIPËRINË 2018 – 2023

NDRYSHIMET MIDIS IÇK DHE IHÇK. RASTI I SHQIPËRISË

ILIRJANA KRAJA¹
DESARA BALLA²

Abstrakt

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) janë instrumente të shprehura në forma të ndryshme të të dhënash statistikore që shërbejnë për të monitoruar ndryshimet e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve që konsumatorët blenë dhe përdorin në një ekonomi. Megjithëse kanë objektiv të përbashkët për të vlerësuar inflacionin, ato ndryshojnë në qëllimin e tyre, përdorimin e tyre.

IÇK është një instrument i përdorur gjerësisht në nivel global dhe përfshin një gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve që një person i zakonshëm ose një familje e mesme mund të konsumojë. Përmban një varg të caktuar të mallrave dhe shërbimeve, si ushqimi, veshjet, transporti, dhe shërbimet e tjera të përditshme që ndikonë në jetën e përdoruesit të zakonshëm. Përdoruesi i zakonshëm është pika e referencës për llogaritjen e IÇK dhe shërben për të ndjekur ndryshimet e çmimeve të konsumit të zakonshëm.

Në anën tjetër, IHÇK është një variant i ndryshëm i indeksit të çmimeve të konsumit, i përdorur kryesisht në Bashkimin Evropian dhe disa vende të tjera europiane. Dallimi kryesor midis IHÇK dhe IÇK është në standardizimin dhe qëllimin e tij. IHÇK është një standard i harmonizuar që është përdorur në të gjitha vendet që e kanë adoptuar dhe është projektuar për të lejuar krahasime më të lehta të ndryshimeve të çmimeve midis vendeve të ndryshme. Përdoruesit kryesorë të IHÇK janë institucionet qeveritare dhe agjencitë ndërkombëtare që përdorin këtë indeks për të monitoruar dhe analizuar performancën ekonomike në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Ky dallim midis IÇK dhe IHÇK është kritik për ekonomistët, analistët ekonomikë, dhe politikëbërësit, pasi ofron perspektiva të ndryshme për të vlerësuar inflacionin dhe për të ndërmarrë masa të përshtatshme politike në reagim ndaj ndryshimeve të çmimeve. Njohja e ndryshimeve midis tyre ndihmon në kuptimin më të mirë të situatës ekonomike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përmirësuar përgatitjen dhe vendimmarrjen e duhur në politikat ekonomike.

Fjalë kyçe:

IÇK, IHÇK, Shporta e mallrave dhe shërbimeve, Peshë produkti

1. Instituti i Statistikave, ikraja@instat.gov.al

2. Instituti i Statistikave, dballa@instat.gov.al

1. HYRJE

Norma e inflacionit është një nga indikatorët që ka një ndikim të rëndësishëm në ekonominë e çdo vendi. Qeveritë përdorin tregues të ndryshme për të matur normën e inflacionit, dy nga treguesit më të zakonshëm janë Indeksi i Çmimeve të Konsumit (ICK) dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK). IÇK dhe IHÇK, si tregues kyç për matjen e inflacionit, sjellin perspektiva të ndryshme në vlerësimin e zhvillimeve ekonomike. Përdorimi i tyre ofron një analizë të pasur dhe të hollësishme të ndryshimeve në koston e jetesës dhe ndihmon në identifikimin e ndikimeve specifike të sektorëve apo aspekteve të tjera të ekonomisë.

IHÇK-të ndërtohen mbi baza të krahasueshme ndërkombëtare, të cilat përcaktohen nga Rregullorja e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian dhe nga Manuali i IHÇK-së. Praktikisht të gjitha kërkesat nga rregulloret e IHÇK-së janë marrë dhe merren në konsideratë edhe në zhvillimet të IÇK-së kombëtare. IÇK-të pavarësisht nga ndryshimet metodologjike të përdorura nga vendet e ndryshme, janë të njohur si matës zyrtar të inflacionit dhe përdoren kryesisht për nevoja të brendshme. IÇK në Shqipëri llogaritet duke përdorur dhe zbatuar një numër të konsiderueshëm rregulloresh të IHÇK-së, duke siguruar kështu një përputhshmëri të lartë midis indekseve.

Njohja e ndryshimeve midis këtyre dy indeksëve përshpejton kuptimin e thellë të dinamikave të tregut dhe lejon politikëbërësit të zhvillojnë masa të përshtatshme në përputhje me kontekstin aktual ekonomik. Kjo ka një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e inflacionit dhe në hartimin e strategjive politike që duhet të ndërmerren në reagim ndaj ndryshimeve të çmimeve në treg. Për ekonomistët, njohja e këtyre ndryshimeve është e domosdoshme për të hartuar analiza të avancuara të zhvillimeve ekonomike dhe për të parashikuar ndikimin e ndryshimeve të mundshme në politikat ekonomike.

Qëllimi ynë është të shpjegojmë pse rezultati i dy indekseve shfaq dallime, duke identifikuar faktorët që ndikojnë në këto ndryshime, por gjithashtu të përcaktojmë elementët e përbashkët që karakterizojnë këto dy indekse. Në këtë punim si fillim, do të jepet një shpjegim së çfarë është dhe çfarë përfaqëson secili nga indekset, kush janë ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre.

2. INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Të kuptuarit e IÇK-së është thelbësore pasi ndihmon politikëbërësit dhe ekonomistët të marrin vendime në lidhje me politikën monetare dhe fiskale në vend. Për shembull, nëse IÇK tregon se inflacioni po rritet, politikëbërësit mund të vendosin të rrisin normat e interesit për të ulur ofertën e parasë, gjë që ndihmon për të ruajtur stabilitetin e çmimeve brenda një vendi. Në mënyrë të ngjashme, nëse IÇK tregon se inflacioni po bie, politikëbërësit mund të vendosin të ulin normat e interesit për të inkurajuar huamarrjen dhe shpenzimet. Gjithashtu, ky tregues u ofron konsumatorëve një pasqyrë të ndryshimeve në koston e jetesës, e cila ndikon në fuqinë e tyre blerëse.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) mat ndryshimin e nivelit të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga njësitë ekonomike familjare për konsum vetjak. Indeksi llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të njërive ekonomike familjare. Ky indeks përdoret si matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Indeksi i parë zyrtar në Shqipëri është llogaritur në muajin Dhjetor 1991 duke pasur si periudhë bazë muajin Dhjetor 1990. Nga viti 1993 e në vazhdim ky indeks është llogaritur dhe publikuar me frekuencë mujore. Gjatë këtyre viteve janë bërë përmirësime të vazhdueshme metodologjike. Indeksi i Çmimeve të Konsumit përdoret si:

- Matës zyrtar i inflacionit në Shqipëri
- Deflator për treguesit e Llogarive Kombëtare;

- Deflator për treguesit e Statistikave Afatshkurtëra;
- Variabël për analizat makro-ekonomike;
- Deflator për indeksimin e pagave, pensioneve, kontratave dhe të ardhurave të tjera kur është e nevojshme;
- Tregues i rëndësishëm për hartimin e politikave monetare për Bankën Qendrore të Shqipërisë.

3. INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit është matës i normës së inflacionit në Bashkimin Evropian (BE). Është një indeks i çmimeve të konsumit që prodhohet nga çdo Shtet Anëtar i BE-së, duke ofruar një matje cilësore dhe të krahasueshme të inflacionit të çmimeve të konsumit. Këta indekse janë të krahasueshëm midis vendeve dhe mund të agregohen. IHÇK-ja shërben për këto qëllime kryesore:

- përdoret si tregues për vlerësimin e konvergjencës së çmimeve në lidhje me një anëtarësim të mundshëm të një vendi në bashkimin monetar (monedha euro);
- është një masë e stabilitetit të çmimeve për strategjinë e politikës monetare të Bankës Qendrore Evropiane (BQE). Këshilli Drejtues i BQE-së ka përcaktuar stabilitetin e çmimeve në terma të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit për zonën e euros
- gjithashtu, përdoret për analiza ekonomike dhe për indeksimin e kontratave.

Është një mjet jetik për politikëbërësit dhe ekonomistët për të përcaktuar normën e inflacionit dhe stabilitetin e çmimeve në BE. IHÇK ofron një matje të standardizuar të normës së inflacionit që mund të përdoret për të krahasuar çmimet midis vendeve të ndryshme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në BE, ku ka shumë vende të ndryshme me monedha të ndryshme dhe nivele të zhvillimit ekonomik të ndryshëm. Duke përdorur një matës të standardizuar të inflacionit, politikëbërësit mund të kuptojnë më mirë situatën e përgjithshme ekonomike në rajon dhe të marrin vendime më kohërente për politikën monetare.

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit mat ndryshimin e nivelit të çmimeve me pakicë të mallrave dhe shërbimeve nga pikëpamja e strukturës së shpenzimeve të cilat konsumatori (vendas dhe i huaj) synojnë për konsumin final në territorin e një vendi. IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve të Evropës dhe si inflacion zyrtar i Bankës Qendrore Evropiane duke siguruar stabilitetin e çmimeve në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar. Ky indeks është publikuar për herë të parë nga INSTAT në Janar 2017 me seri kohore që nga viti 2016. Ky indeks transmetohet çdo muaj në Eurostat. Duke filluar nga muaji Dhjetor 2022 ky indeks publikohet çdo muaj në website të Eurostat.

4. NGJASHMËRITË DHE NDRYSHIMET MIDIS IÇK DHE IHÇK NË SHQIPËRI

4.1 Ngjashmëritë

Indeksi i Çmimeve të Konsumit dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit janë hartuar për të matur ndryshimin e nivelit mesatar të çmimeve të paguara për konsumin e mallrave dhe shërbimeve nga të gjithë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri. IÇK dhe IHÇK përdoren si matës të inflacionit të konsumit.

INSTAT, mbledh, përpunon dhe publikon IÇK dhe IHÇK në përputhje me aktet ligjore kombëtare:

- Ligjin Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare;
- Programin e Statistikave Zyrtare, 2022-2026;

Të dy indekset ndjekin dhe përdorin të njëjtën metodologji (Sipas kornizës ligjore të BE-së). Ato bazohen në:

- Rregulloren e BE-së 2016/792 për indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumit dhe indeksit të çmimeve të banesave;
- Rregulloren e BE-së 2020/1148 që përcakton specifikimet metodologjike dhe teknike në lidhje me IHÇK-në në përputhje me rregulloren e BE-së 2016/792.

IÇK dhe IHÇK llogariten bazuar në të njëjtat burime të dhënash. Çmimet e mbledhen në të njëjtat njësi tregtare. Numri i çmimeve të mbledhura për artikujt e shportës është mesatarisht rreth 23,027 çdo muaj. Të dy indekset përkufizohen si indekse të tipit Laspeyres³, të cilat llogariten duke përdorur indekset e agreguara elementare mujore dhe peshat që përfaqësojnë modelin e shpenzimeve në periudhën e referencës së peshave. Peshat për të dy treguesit përditësohen çdo vit. Treguesit që publikohen për IÇK dhe IHÇK janë:

- Indeksi IÇK dhe IHÇK 2020=100 - që është raporti i çmimeve të një shporte mallrash dhe shërbimesh në një vit të dhënë me çmimet e vitit bazë.
- Ndryshimet vjetore - mat ndryshimin e indeksit të çmimeve ndërmjet muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm.
- Ndryshimet mujore - mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm.
- Ndryshimet mestare vjetore - mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm

Gjithashtu, këto dy indekse përdorin të njëjtin klasifikim të mallrave dhe shërbimeve, Klasifikimin Evropian të Konsumit Individual sipas Qëllimit (ECOICOP) i përputhshëm plotësisht me strukturën e shpenzimeve që përdor EUROSTAT. Bazuar në këtë klasifikim shpenzimet janë klasifikuar në 12 grupe kryesore si më poshtë:

1. Ushqime, pije alkoolike dhe duhan
2. Pije alkoolike dhe duhan
3. Veshje dhe këpucë
4. Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji elektrike
5. Mobilitet, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje
6. Shëndetësi
7. Transport
8. Komunikim
9. Arsimit dhe kulturë
10. Shërbim arsimor
11. Hotele, kafene dhe restorante
12. Mallra dhe shërbime të tjera

IÇK dhe IHÇK kanë të njëjtat periudha referuese të çmimeve dhe indeksit. Periudha reference e çmimeve është

3. "Indeksi i tipit Laspeyres" është një indeks i çmimeve të konsumit që përdoret për të matur ndryshimin e çmimeve të një shporte fikse mallrash dhe shërbimesh në periudhën korrente krahasuar me një periudhë tjetër (e konsideruar si periudha bazë). Peshat e mallrave dhe shërbimeve mbahen fikse gjatë gjithë vitit.

muaji Dhjetor i një viti më parë (t-1). Ndërsa, periudha referencë e indeksit është muaji Dhjetor 2020 (Dhjetor 2020=100).

4.2 Ndryshimet

Siç cituam më lartë, IÇK dhe IHÇK matin ndryshimin në nivelin mesatar të çmimeve të një shportë fikse mallrash dhe shërbimesh të konsumit. Por, këto indekse kanë disa ndryshime si më poshtë:

a) Qëllimi

Qëllimet e tyre janë të ndryshme:

- ✓ IÇK është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Ky indeks është hartuar kryesisht për të pasqyruar ndryshimet e çmimeve vetëm nga familjet rezidente në territorin e Shqipërisë. Ai përdoret për qëllime makroekonomike, për monitorimin e stabilitetit të çmimeve në vend, për indeksimin e pagave, pensioneve, kontratave, etj
- ✓ IHÇK është një matës ndërkombëtar për krahasueshërinë e normës së inflacionit ndërmjet vendeve Evropiane. Ky indeks është projektuar kryesisht si një tregues makroekonomike, për përdorim nga Banka Qendrore Evropiane për monitorimin e stabilitetit të çmimeve dhe konvergjencën e çmimeve në zonën e euros.

b) Mbulimi dhe burimi i të dhënave për shpenzimet (peshat e shportës)

IÇK mbulon të gjitha shpenzimet e bëra nga të gjithë rezidentët brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (duke ndjekur të ashtuquajturin “koncepti National”). Shpenzimet e jorezidentëve si, turistët dhe shtetasit shqiptarë (të cilët jetojnë jashtë vendit) dhe shqiptarët që jetojnë në banesa kolektive (shtëpitë e kujdesit, burgje etj) janë përjashtuar. IÇK përfshin transaksionet monetare dhe jo monetare (qiraja e imputuar). IÇK krahason të gjitha blerjet e bëra nga familjet shqiptare brenda dhe jashtë territorit të vendit, vetëm nga personat rezident. IÇK përjashton interesat dhe kartat e kreditit, duke i konsideruar ato si kosto financiare, jo si shpenzime konsumatore. Burimi kryesor i të dhënave për shpenzimet (“peshat”) është Anketa e Buxhetit të Familjeve (ABF) dhe plotësohet me të dhënat e Llogarive Kombëtare.

IHÇK mbulon të gjitha shpenzimet e bëra nga të gjithë rezidentët dhe jo-rezidentët brenda territorit të Republikës së Shqipërisë (duke ndjekur të ashtuquajturin “koncepti Domestic”). Shpenzimet e bëra nga familjet jashtë vendit përjashtohen. IHÇK mbulon vetëm transaksionet monetare; qiraja e imputuar është e përjashtuar. IHÇK mbulon çmimet e paguara për mallra dhe shërbime në shkëmbime financiare. Çmimet që maten janë ato që faktikisht paguhet nga konsumatori. IHÇK përjashton interesat dhe kartat e kreditit, duke i konsideruar ato si kosto financiare dhe jo si shpenzime konsumatore. Burimi kryesor i të dhënave për peshat janë të dhënat e “Shpenzimet Monetare Finale të Konsumit të Familjeve” (HFMCE) dhe plotësohet me të dhëna të detajuara të ABF-së.

Pra, IÇK dhe IHÇK kanë pesha të ndryshme për produktet e shportës të cilat përditësohen çdo vit. Peshat për llogaritjen e indekseve për vitin 2023 janë si në tabelën më poshtë:

Tabela 1. Peshat për 12 grupet kryesore

COICOP	Përshkrimi	IÇK	IHÇK
01	Ushqime dhe pije joalkoolike	35,6	33,5
02	Pije alkoolike dhe duhan	4,9	4,7
03	Veshje dhe këpucë	3,6	3,6
04	Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji	19,5	5,7
05	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje	7,4	5,8
06	Shëndeti	4,2	5,2
07	Transporti	6,4	8,5
08	Komunikimi	3,1	1,7
09	Argëtim dhe kulturë	2,3	9,3
10	Shërbimi arsimor	3,0	5,3
11	Hotele, kafene dhe restorante	4,5	13,4
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,5	3,5

Burimi: INSTAT

c) Mbulimi i produkteve

Përzgjedhja e mallrave dhe shërbimeve të shportës është bazuar në rezultatet e Anketës së Buxhetit të Familjes.

- Shporta e IÇK-së përmban 331 produkte
- Shporta e IHÇK-së përmban 329 produkte (qiraja e imputuar dhe lojrat e fatit janë përjashtuar)

Numri i artikujve i shpërndarë sipas 12 grupeve kryesore është si në tabelën më poshtë

Tabela 2. Numri i artikujve të shportës sipas 12 grupeve kryesore


COICOP	Përshkrimi	IÇK	IHÇK
01	Ushqime dhe pije joalkoolike	101	101
02	Pije alkoolike dhe duhan	6	6
03	Veshje dhe këpucë	40	40
04	Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji	13	12
05	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje	42	42
06	Shëndeti	12	12
07	Transporti	20	20
08	Komunikimi	8	8
09	Argëtim dhe kulturë	36	35
10	Shërbimi arsimor	7	7
11	Hotele, kafene dhe restorante	19	19
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	27	27

Burimi: INSTAT

5. KRAHASIME TË REZULTATEVE IÇK DHE IHÇK

Indeksi i Çmimeve të Konsumit dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit llogariten dhe publikohen çdo muaj nga INSTAT. Nga sa thamë më lartë këto indekse përdorin të njejtën metodologji në ndërtimin, përpunimin dhe publikimin e rezultateve. Një ndër ndryshimet kryesore midis tyre është peshat e produkteve. Janë këto pesha që bëjnë që të ketë dhe ndryshime në rezultatet e këtyre dy indekseve. Në grafikun 1 janë dhënë ndryshimet vjetore të IÇK dhe IHÇK nga Janari 2020 deri Dhjetor 2023. Shikojmë se gjatë gjithë periudhës ka diferenca midis ndryshimeve vjetore të këtyre dy indekseve. Ky ndryshim është midis 0,1 pikë përqindje deri në 1,3 pikë përqindje.


Grafik 1. Ndryshimet vjetore IÇK dhe IHÇK, sipas muajve



Burimi: INSTAT

Gjatë vitit 2023 ndryshimi mesatar vjetor i IÇK ishte 4,8 %, ndërsa ndryshimi vjetor i IHÇK ishte 5,3 %. Në grafikun më poshtë jepen kontributet që ka dhënë secili grup në ndryshimin mesatar vjetor për secilin indeks.


Grafik 2 : Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor, IÇK dhe IHÇK, 2023



Burimi: INSTAT

Diferenca më e madhe e kontributeve midis ky indekseve gjatë vitit 2023 shikohet te grupet; 09 “Argëtim dhe kulturë”, 11 “Hotele, kafene dhe restorante” dhe 07 “Transporti” (të cilat kanë kontribut më të madh në rritjen mesatare vjetore të IHÇK-së gjatë këtij viti) dhe 04 “Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe 01 “Ushqime dhe pije joalkolike” (të cilat kanë kontribut më të madh në rritjen mesatare vjetore të IÇK-së gjatë këtij viti).

Grafik 3 : Struktura e peshave, IÇK dhe IHÇK, 2023



Burimi: INSTAT

Tre grupet që kanë diferencat më të mëdha të peshave janë grupi 04 “Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji”, 09 “Argëtim dhe kulturë” dhe 11 “Hotele, kafene dhe restorante”.

6. KONKLUZIONE

Pas krahasimit të IHÇK-së dhe IÇK-së, është e qartë se të dyja janë matës të dobishëm të inflacionit. IHÇK është ideal për analizimin e inflacionit në tregtinë ndërkombëtare dhe përdoret shpesh nga politikëbërësit. Nga ana tjetër, CPI është më i përshtatshëm për matjen e inflacionit brenda një vendi të caktuar dhe përdoret nga publiku i gjerë për të gjurmuar ndryshimet në çmime.

IHÇK do të vazhdojë të jetë një mjet i rëndësishëm për politikëbërësit në BE, pasi shërben si një input kyç për vendimet e politikës monetare të BQE-së. Ndërsa, BE vazhdon të integrohet dhe zgjerohet, IHÇK mund të bëhet edhe më i rëndësishëm për të kuptuar presionet inflacioniste në të gjithë rajonin.

Në rastin e Shqipërisë këto dy indekse përdorin të njëjtën bazë ligjore dhe metodologji për mbledhjen, përpunimi dhe publikimin e tyre. Për llogaritjen e tyre përdoren të njëjtat çmime për mallrat dhe shërbimet e shportës. Ndryshimi kryesor midis tyre është pesha e produkteve, që sjell dhe ndryshime në matjen e normave të inflacionit nga të dy indekset. Për shembull, IÇK ka një peshë më të lartë të rentës së imputuar, ndërsa IHÇK nuk e ka të përfshirë (kjo duke u bazuar në rregulloren e këtij indeksi). Kjo do të thotë se norma e inflacionit e llogaritur nga çdo masë mund të ndryshojë ndjeshëm nga njëra-tjetra, në varësi të ndryshimeve në çmimet e kategorive të ndryshme të mallrave dhe shërbimeve.

REFERENCA

1. Consumer Price index Manual, Concepts and Methods 2020: <https://unece.org/sites/default/files/2020-12/cpi-manual-concepts-and-methods.pdf>
2. <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/9479325/KS-GQ-17-015-EN-N.pdf/d5e63427-c588-479f-9b19-f4b4d-698f2a2?t=1547028935000>
3. Raporti i Cilësisë: https://www.instat.gov.al/media/11274/1ick_esms_final_al.pdf
4. <https://www.instat.gov.al/al/temat/%C3%87mimet/>
5. https://www.instat.gov.al/media/11274/1ick_esms_final_al.pdf

PËRDORIMI I BURIMEVE ADMINISTRATIVE NË VLERËSIMET E STATISTIKAVE AFATSHKURTRA

KLODIANA GURRA¹

STEISI MICI²

XHULIANA MUÇO³

Abstrakt

Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha mujore dhe tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë, si dhe mund të bëhen parashikime apo analiza për periudha afat-shkurtra apo afat-mesme. Metoda e mbledhjes së të dhënave për këto statistika realizohet përmes anketës dhe burimeve administrative.

Në mënyrë të vazhdueshme, institutet e prodhimit të statistikave zyrtare, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së statistikave dhe uljes së kostove orientojnë vendet drejt përdorimit të burimeve administrative. Ky artikull informativ ka si qëllim pasqyrimin e rëndësisë që ka kombinimi i burimeve të shumta administrative, si një metodë efçente për të zëvendësuar plotësisht ose pjesërisht, mbledhjen e të dhënave statistikore përmes anketimit. Ky informacion statistikor është i rëndësishëm dhe i nevojshëm për hartimin e politikave dhe vendimmarrjen në një mënyrë sa më efkase dhe të qëndrueshme.

Ky artikull, gjithashtu, synon të kontribuojë në njohjen më të mirë të avantazheve dhe sfidave të përdorimit të burimeve administrative me qëllim përmirësimin e proceseve të prodhimit statistikorë në një nivel më të avancuar dhe me efikasitet të lartë. Me rëndësi është evidentimi i faktit se burimet administrative ofrojnë të dhëna më të sakta dhe të qëndrueshme, pasi ato janë shpesh të mbledhura për qëllime administrative të tjera dhe kanë një bazë të gjerë të dhënash. Kjo mundëson prodhimin e statistikave më të besueshme dhe në kohë, duke iu përshtatur nevojave aktuale të politikës publike dhe shoqërisë.

Fjalë kyçe:

Statistika afatshkurtra, Të dhëna administrative, TVSH, Listëpagesë, Anketë

1. Instituti i Statistikave, kgurra@instat.gov.al

2. Instituti i Statistikave, smici@instat.gov.al

3. Instituti i Statistikave, xmuco@instat.gov.al

1. HYRJE

Burimet e të dhënave administrative konsiderohen kryesisht si grumbullim i të dhënave të mbajtura nga organizatat e sektorit qeveritar, të mbledhura dhe të përdorura për qëllime administrative si taksat ose shërbimet. (Iwig, B, Berning). Çdo ditë, sasi të mëdha të dhënash gjenerohen nga veprimet që ne ndërmarrim, si pagimi i taksave ose kryerja e transaksioneve financiare.

Ashtu si pjesa më e madhe e organizatave të tjera statistikore, Instituti i Statistikave, mbështet veprimtarinë statistikore duke përdorur të dhënat administrative për të zëvendësuar të dhënat nga anketimi ose si informacion plotësues për to. Nëse të dhënat administrative përdoren siç duhet, INSTAT mund të përmbushë nevojat e reja dhe të vazhdueshme për informacion, të përmirësojë cilësinë e të dhënave, të ulë kostot e mbledhjes së informacionit dhe të kursejë kohë për ata që marrin pjesë në anketat e zhvilluara. Të dhënat administrative janë veçanërisht të dobishme për mbledhjen e informacionit mbi popullatat ose subjektet kur hulumtimi i anketimit mund të kërkojë kohë ose kosto të larta.

Për të përfaqësuar kërkesat për informacion të përdoruesve të të dhënave dhe interesat e palëve të tjera të interesuar, INSTAT synon të zhvillojë, prodhojë dhe prezantojë të dhëna të sakta dhe aktualizuar. Kështu, për të vlerësuar përdorshmërinë e të dhënave administrative në kuadër të statistikave, ato janë të përcaktuara në përputhje me kriteret e caktuara më parë. Këto kriterë përfshijnë rëndësinë, afatin kohor, saktësinë, aksesueshmërinë, interpretueshmërinë dhe koherencën. Kuadri i Sigurimit të Cilësisë i Statistikave të Shqipërisë ofron një panoramë të gjerë të strategjisë së përdorur për të ndihmuar sektorët e programeve statistikore në përpjekjet e tyre për të arritur një ekuilibër të përshtatshëm midis aspekteve të ndryshme të cilësisë dhe faktorëve të ndryshëm që lidhen me nevojat e përdoruesve, kostot, dhe nivelin e mospërgjigjes.

INSTAT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione qeveritare, përfshirë Drejtorinë e Organeve Tatimore, Institutin e Sigurimeve Shoqërore etj, për të siguruar qasje të përhershme dhe të rregullt në të dhënat administrative. Kjo është një mënyrë për të garantuar që INSTAT disponon dhe përdor të dhënat administrative në përputhje me standardet dhe kriteret e cilësisë të caktuara për të prodhuar statistika të besueshme dhe të nevojshme për komunitetin dhe vendimarrjen.

Instituti i Statistikave siguron privatësinë dhe konsistencën duke mbledhur vetëm informacionin e nevojshëm për prodhimin e statistikave duke mbrojtur të dhënat nga aksesit dhe përdorimi i paautorizuar si dhe ruan konfidencialitetin duke mos zbuluar informacione që mund të identifikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi një individ, familje ose biznes.

2. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI STATISTIKAT AFATSHKURTRA NË SHQIPËRI

Statistikat afatshkurtra përshkruajnë zhvillimet ekonomike me anë të indekseve për prodhimin, shitjet neto, si dhe për disa tregues të tjerë (kostot e ndërtimit, punonjësit, pagat). Sektori i Statistikave Afatshkurtra përfshin gjithashtu tregues tremujorë për regjistrimet e bizneseve dhe falimentimet Eurostat (2023).

Sektorët e ekonomisë për të cilët ofrohen të dhëna janë:

- Industri
- Ndërtim
- Tregti
- Shërbime, duke përfshirë shërbimet financiare dhe publike

Statistikat afatshkurtra japin informacion mbi një gamë të gjerë aktivitetesh ekonomike të ndërmarrjeve, të përzgjedhura nga Regjistri Statistikor i Bizneseve dhe të klasifikuara sipas nomenklaturës NVE Rev.2 (Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian) për ndërmarrjet që veprojnë në vendin tonë.

Qëllimi i statistikave ekonomike afatshkurtra është të paraqitet ecuria e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Të gjithë treguesit e prodhuar shprehen në formë indeksi, të parregulluar dhe të rregulluar sezonalisht. Përveç kësaj paraqiten gjithashtu ndryshimet vjetore dhe tremujore.

Të dhënat e anketës tremujore pranë ndërmarrjeve (ATN) mblidhen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe prodhohen afërsisht 75 ditë pas tremujorit referues. Viti bazë është 2015=100 duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2019.

Për tregtinë me pakicë të dhënat mblidhen çdo tremujore me informacion mujore. E njëjta gjë vlen edhe për procesin e prodhimit dhe publikimit, publikimi tremujore me të dhëna mujore.

Sektori i statistikave afatshkurtra aktualisht ka 10 lloje anketash të përdorura për aktivitete të ndryshme si: Industri, Ndërtim, Tregti me Pakicë dhe Shitje me Shumicë, Hotele, Bar restorante, Aktivitete Informatike, Inxhinieri Arkitekturore, Transport - Magazinim dhe Postë, Agjenci udhëtimi.

- Mbledhja e të dhënave kryhet çdo tremujor.
- Të dhënat mblidhen nga anketuesit me pyetësorë në letër në intervistat ballë për ballë për ato ndërmarrje që nuk janë të pranishme në të dhënat administrative (PAPI).
- Të dhënat mblidhen 15 ditë pas përfundimit të periudhës së referencës.
- Kohëzgjatja e procesit të mbledhjes së të dhënave është 15 ditë pune.

2.1 Burimet administrative

Për të krijuar statistika zyrtare, INSTAT ka mundësinë të zhvillojë, të diskutojë dhe të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me institucionet që janë në gjendje të ofrojnë të dhëna administrative. Në këtë kontekst, INSTAT ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të përdorur të dhënat administrative, veçanërisht ato lidhur me Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe të dhënat e sigurimeve shoqërore. Këto të dhëna administrative dërgohen në mënyrë zyrtare në format elektronike, në përputhje me afatet e përshkruara në marrëveshje me institucioneve.

Burimet administrative janë një mjet i rëndësishëm për të prodhuar statistika zyrtare, dhe për këtë qëllim, INSTAT mund t'i përdorë ato për:

- Krijimin e statistikave zyrtare me baza të drejtpërdrejta nga të dhënat administrative.
- Sigurimin e informacioneve shtesë në nivel të detajuar ose të përmbledhur.

- Ruajtjen dhe përditësimin e regjistrave statistikore.
- Vlerësimin e cilësisë së të dhënave statistikore, duke përfshirë koherencën dhe krahasueshmërinë.

Përveç kësaj, burimet administrative janë të rëndësishme për vlerësimin e të dhënave statistikore në periudha të shkurtra, veçanërisht në lidhje me të gjitha kompanitë që raportojnë për TVSH dhe sigurimet shoqërore. Këto burime sigurojnë një bazë të fortë për prodhimin e statistikave zyrtare dhe ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së tyre (Bazuar në Delden V. & L, 2023).

3. TË DHËNAT ADMINISTRATIVE NË STATISTIKAT AFATSHKURTRA

Prodhimi i statistikave afatshkurtra në thelb varet nga të dhënat administrative, duke përjashtuar këtu të dhënat e mbledhura drejtpërdrejt nga anketa, burimi kryesor i të dhënave administrative për ATN janë të dhënat mujore të TVSH-së dhe listëpagesës.

Deri në vitin 2020, sektori i statistikave afatshkurtra përdorte një metodologji të ndryshme për mbledhjen, vlefshmërinë dhe përpilimin e të dhënave. Të dhënat mbledheshin drejtpërdrejt duke intervistuar me pyetësor në letër, çdo tremujor, 15 ditë pas përfundimit të periudhës së referencës dhe i gjithë kampioni mbulonte rreth 10.000 ndërmarrje. Të dhënat e TVSH-së përdoreshin për imputimin dhe rishikimin e informacionit të terrenit me qëllim identifikimin (dhe korrigjimin) e gabimeve.

Viti 2020 ka qenë një vit plot sfida të reja dhe mundësi zhvillimi për INSTAT-in në drejtim të ofrimit të të dhënave të besueshme dhe të krahasueshme për përdoruesit, si dhe nga ana e prodhuesve për të gjetur mënyra për përshtatje të metodologjive dhe strategjive inovative dhe krijimit të mundësive të reja në mjediset e punës për të siguruar vazhdimësinë e prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare.

INSTAT ndërpreu intervistat e drejtpërdrejta me sipërmarrjet për shkak të pandemisë Covid-19, ndaj u desh të adoptohej një metodologji të re për të vijuar procesin e punës për prodhimin e statistikave afatshkurtra. Për t'iu përgjigjur situatës së krijuar u përdorur metoda e kombinuar e të dhënave administrative dhe intervistave telefonike. Kjo situatë ka qenë e pranishme vetëm në vitin 2020.


Kjo periudhë solli një evolucion të ri i cili vazhdon të aplikohet, sektori i statistikave afatshkurtra prodhon të dhëna bazuar në dy burime: burimet administrative (TVSH) dhe listën e pagave si dhe mbledhjen e të dhënave në terren me pyetësor me metodën PAPI vetëm për ato ndërmarrje që nuk janë pjesë e TVSH-së e cila tashmë është zë rreth 30% të kampionit.

Synimi dhe qëllimi i INSTAT është që të ketë një përdorim më të madh të burimeve administrative për prodhimin e të dhënave statistikore, por ndryshimet në ligjin tatimor në Shqipëri gjatë këtyre viteve të fundit konsiderohen si një sfida. Në vitin 2021, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njoftoi uljen e pragut të qarkullimit vjetor të ndërmarrjeve që nuk janë subjekt i deklarimit të TVSH-së. Kjo do të thotë se mbulim administrativ (TVSH) ka qenë më i lartë para vitit 2021 në krahasim me situatën aktuale, sepse ndërmarrjet deri në këtë qarkullim vjetor janë të përjashtuara nga ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Ky ndryshim i ri ka ndikim shumë më të ndjeshëm në aktivitete si tregtia me pakicë dhe shërbimet, sepse ato kanë një numër më të madh të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Ilustruar më poshtë gjenden grafikët referuar mbulimit të të dhënave nga burimi administrativ TVSH nga viti 2020 në 2022:

a. Në vitin 2020, mbulimi i TVSH-së ka qenë 81,4% e sample total të ATN-së


Figura 1. Mbulimi i kampionit të ATN nga burimi administrativ



Burimi: INSTAT, përpunuar nga autorët

b. Në vitin 2021, 70,1% e sample ka qenë mbuluar nga burimi administrativ i TVSH


Figura 2. Mbulimi i kampionit të ATN nga burimi administrativ



Burimi: INSTAT, përpunuar nga autorët


c. Në vitin 2022 , mbulimi i TVSH-së ka qenë 68,4% e sample të ATN-së

Figura 3. Mbulimi i kampionit të ATN nga burimi administrativ



Burimi: INSTAT, përpunuar nga autorët

Figura 4. Mbulimi i kampionit të ATN nga burimi administrativ



Burimi: INSTAT, përpunuar nga autorët

Siç mund të evidentohet nga grafiket e mësipërm , ka një tendencë në rënie të mbulimit të TVSH nga viti 2020 në 2022.

4. ANALIZA E TË DHËNAVE

Për të vlerësuar cilësinë e treguesve të prodhuar, u analizua devijimi standard për treguesin e shitjeve dhe punësimit. Vlerësimet e devijimit standard ndahen në dy kategori:

- vlerësime me një devijim standard më të madh se 5%;
- vlerësime me një devijim standard më të madh se 3%.

Nga analiza e kryer për të gjitha fushat e publikimit, u vu re se në vitin 2021, 4% e fushave publikuese për treguesin e shitjeve neto kishin një devijim standard më të madh se 5%. E njëjta tendencë vërehet edhe në vitin 2022.

Tabela 1. Devijimi standart për treguesin shitje Neto

Devijimi Standart / Shitjet Neto						
	2021	2022	Tr_01_2021		Tr_01_2021	
			>5	>3	>5	>3
			2	7	3	10
			4%	13%	5%	16%
Domains	56	61				

*> - Më e madhe se

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autorët

4.1 Kontrolli i cilësisë së të dhënave të TVSH-së

Mbështetja në burimet e të dhënave administrative kërkon bashkëpunim të ngushtë me ofruesit e tyre. Është e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm për të gjitha ndryshimet e mundshme në legjislacion dhe pragje. Për më tepër, mjetet administrative të përpunimit të të dhënave duhet të jenë sa më të standardizuara në mënyrë që të lejojnë përditësim automatik kur ka ndryshime në ligj (Peltola A., 2008).

Të dhënat administrative janë të prirura për gabime shtypi dhe mospërputhje konceptuale gjatë integritetit të të dhënave. Për më tepër, fushëveprimi i informacionit është i kufizuar kur njësia statistikore është një person juridik dhe jo një ndërmarrje. Varësia nga të dhënat administrative mund të shihet ndonjëherë si një shqetësim i mundshëm gjatë prodhimit të statistikave. Gabime ndeshen në të dhënat administrative e si rezultat, është e nevojshme të bëhen disa ndryshime për të kapërcyer këto pengesa. Në sektorin e statistikave afatshkurtra, specialistët kryejnë procese editimi për të rregulluar disa probleme të të dhënave administrative. Në rast të mungesës së të dhënave administrative, ata zgjedhin disa metoda të imputimit si për shembull:

$$\hat{x}_t = \frac{x_{t-1} + x_{t-2} + x_{t-3}}{x_{t-13} + x_{t-14} + x_{t-15}} * x_{t-12}$$

Ndryshimi mesatar vjetor

$$\hat{x}_t = x_{t-1} \sqrt{\frac{x_{t-1} x_{t-2}}{x_{t-2} x_{t-3}}}$$

Mesatarja gjeometrike e ndryshimeve mujore

$$\hat{x}_t = x_{t-1}$$

Shitjet neto të një periudhe më parë

$$\hat{x}_t = \text{avg}(x_{t-1}, x_{t-2}, x_{t-3})$$

Mesatarja e shitjeve neto

$$\hat{x}_t = x_{t-12}$$

Vlera e shitjeve neto të të njëjtit muaj të një viti më parë

x – Vlera e shitjeve neto në një periudhë të caktuar **t**

t – Periudha

$\hat{x}_t$ – Vlera e shitjeve neto aktuale

Rregullat e imputimit shpesh zgjidhen në bazë të të cilave dikush ka gabimin më të vogël të parashikimit.

5. KONKLUZIONE

Të dhënat e TVSH-së si dhe të dhënat e sigurimeve shoqërore për listat e pagave kanë ofruar një mori mundësisht për zgjerimin e fushës dhe konsistencës së statistikave. Ato janë gjithnjë e më shumë baza e statistikave ekonomike.

Arsyet kryesore që tregojnë rëndësinë e përdorimit të burimeve administrative në prodhimin e statistikave janë:

- Përditësohen shpesh dhe janë lehtësisht të disponueshme, duke lejuar prodhimin në kohë të statistikave, veçanërisht e rëndësishme kjo për proceset e vendimmarrjes që kërkojnë informacion të përditësuar.
- Kanë konsistencë dhe krahasueshmëri me kalimin e kohës.
- Ofrojnë një pamje sa më të qartë të fenomeneve komplekse, duke ofruar një pamje më të qartë të tendencave sociale, ekonomike dhe demografike.
- Sigurojnë saktësi dhe besueshmëri për të dhënat e përdorura në prodhimin statistikor.
- Raporti kosto-efektivitet është më i mirë në krahasim me metodat e tjera të mbledhjes së të dhënave.

Ndërsa të dhënat administrative ofrojnë avantazhe të shumta, ka edhe sfida që lidhen me stabilitetin e tyre që duhet të adresohen pasi mund të ndikojnë në cilësinë, besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e informacionit statistikor. Dy nga pikat kryesore që janë probleme aktuale janë : ndryshimi i legjislacionit dhe ruajtja e të dhënave kofidenciale.

Adresimi i këtyre sfidave kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet zyrave statistikore dhe politikëbërësve. Përmirësimi i mekanizmave të kontrollit të cilësisë së të dhënave dhe promovimi i standardizimit janë hapa që duhen ndërmarrë në kapërcimin e çështjeve të lidhura me stabilitetin e përdorimit të burimeve administrative në prodhimin statistikor.

REFERENCA

1. Delden, V. and Delden, L., (2023), Methodology for use of administrative data in business surveys, Chapter 12 in: ICES VI book.
2. INSTAT (2023), Statistikat Afatshkurtra.
<https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/statistikat-afatshkurtra/>
3. INSTAT (2015), Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rishikimi 2.
4. Iwig, B., Berning, M., Marck, P. and Prell, M.,(2013), Data Quality Assessment Tool for Administrative Data, February.
<http://www.bls.gov/osmr/datatool.pdf>
5. Peltola, A., (2008), Use of multiple data sources in short term statistics - Combining administrative and survey data, Workshop on Business Data Collection Methodology, Ottawa, Canada.

NGJARJET DEMOGRAFIKE TË BIZNESEVE NË SHQIPËRI

FLUTURA SALA¹
KOZETA HAXHILLARI²

Abstrakt

Fjala "Demografi" është një kombinim i dy fjalëve greke, "Demos" që do të thotë njerëz dhe "Graphy" që do të thotë shkencë. Kështu, demografia njihet si shkencë e njerëzve. Në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë në 1855, fjala "Demografi" u përdor për herë të parë nga një shkrimtar francez Achille Guillard.

Edhe pse termi "Demografia e popullsisë" është më i popullarizuar, fjala "Demografi" ka një përdorim më të gjerë këto ditë, sidomos në prodhimin e statistikave zyrtare. Interesi për statistikën e demografisë së biznesit është rritur pasi ato janë burim informacioni për inovacionin, konkurrencën, rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës. Statistikat e demografisë së biznesit (BD) ofrojnë informacion mbi dinamikën e ekonomisë së biznesit. Ato tregojnë kontributin në një sërë karakteristikash të ndërmarrjes, kryesisht në zhvillimin e ekonomisë.

Qëllimi i artikullit është të paraqesë të dhëna statistikore mbi demografinë e biznesit në Shqipëri bazuar në regjistrat e biznesit të përditësuar çdo vit nga Instituti i statistikave, INSTAT.

Fjalë kyçe:

Ngjarjet demografike; Regjistrat e Biznesit; Ndërmarrjet aktive;
Ndërmarrjet e reja; Shkalla e lindshmërisë (lindshmëria).

1. Instituti i Statistikave, frama@instat.gov.al

2. Instituti i Statistikave, khaxhillari@instat.gov.al

1. HYRJJE

Në shekullin XXI, ndikimi i ndryshimeve demografike në ekonominë e një vendi është bërë më i rëndësishëm se kurrë më parë. Termi “Demografi” rrjedh nga fjala greke “Demos” për njerëzit dhe “Graphy” për shkencën. Ngjarjet demografike në biznes na sigurojnë një panoramë të qartë në studimin e strukturave dhe ndryshimet ekonomike të një vendi, duke analizuar rritjen dhe përqendrimin në sektor të ndryshëm të ekonomisë.

Në kontekstin e Shqipërisë, ku ekonomia dhe ndryshimet sociale janë në një fazë zhvillimi, analiza e ngjarjeve demografike dhe ndikimi i tyre mbi bizneset bëhet më i rëndësishëm.

Në vitin 2022, vëmë re një rritje të konsiderueshme në numrin e ndërmarrjeve të reja, veçanërisht në sektorët e shërbimeve, industrisë dhe ndërtimit. Edhe gjatë këtij viti sektori i shërbimeve është mbizotërues duke pasur rritjen më të madhe, e ndjekur nga industria dhe ndërtimi. Rritja më e madhe është hasur në qarkun e Tiranës, Vlorës dhe Durrësit, ndërsa rritja më e vogël është hasur në qarkun Gjirokastrë dhe Kukës.

Ky studim ka në fokus të hedhë dritë mbi ndërveprimet midis ngjarjeve demografike dhe zhvillimit të biznesit në Shqipëri. Të dhënat i referohen vitit 2022 dhe analizojnë në mënyrë të detajuar zhvillimet demografike, duke ndjekur metodologjinë Evropiane. Përmes këtij studimi, synohet të krijohet një bazë e të dhënave që mund të ndihmojnë politikë-bërësit, investitorët dhe përdoruesit e tjerë të interesuar mbi dinamikën e biznesit në vend. Kjo nënkupton një analizë për ndërmarrjet aktive dhe ato të reja, se si ato zhvillohen nga një sektor në tjetrin dhe ndikimin e tyre në punësimin dhe zhvillimin ekonomik. Duke përdorur të dhënat nga regjistrat statistikore të biznesit, studimi jep një pasqyrë të hollësishme mbi zhvillimet aktuale të bizneseve shqiptare.

2. METODOLOGJIA

Fusha e mbulimit, Statistikat mbi demografinë e biznesit mbulojnë bizneset me aktivitet ekonomik sipas nomenklaturës së veprimtarive ekonomike NVE Rev.2 (seksionet B deri N, P deri R si dhe ndarjen S95 dhe S96), e cila përfshin: industrinë, ndërtimin dhe shërbimet.

Regjistrat e Biznesit përmbajnë të gjitha njësitë ligjore, ndërmarrjet, aktivitetet ekonomike e të cilave kontribuojnë në Prodhimin e Brendshëm Bruto (P.B.B) dhe të gjitha njësitë lokale të tyre. Statusi i ndërmarrjes është një variabël pjesë e regjistrave të biznesit i cili përditësohet çdo vit me anë të burimeve administrative si dhe të vrojtimeve statistikore të zhvilluara nga Instituti i Statistikave, INSTAT.

Ndërmarrja si koncept është: ”kombinimi më i vogël i njësive ligjore pra një njësi organizative e cila prodhon të mira apo shërbime dhe ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)”.

Një aktivitet ekonomik ndodh kur burime të tilla si mallrat kapitale, puna, teknikat e prodhimit ose produktet ndërmjetës janë të kombinuara për të prodhuar mallra ose shërbime specifike. Kështu, një aktivitet ekonomik është i karakterizuar nga një kontribut i burimeve, një proces të prodhimit dhe një prodhim të produkteve (mallra ose shërbime).

Nomenklatura e veprimtarive ekonomike (NVE) është klasifikim në nivel katërshifror i veprimtarive ekonomike të ushtruara nga ndërmarrjet. Kjo nomenklaturë është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr.320 datë 28.5.2014 dhe është përkthimi dhe përshtatja e Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike të Komunitetit Evropian NACE Rev. 2.

Lindja e ndërmarrjes ndodh kur një ndërmarrje (për shembull një kompani a biznes) fillon nga e para, duke arritur në krijimin e një kombinimi të faktorëve të prodhimit me kufizimin që asnjë ndërmarrje tjetër të mos përfshihet në këtë ngjarje. Lindja e ndërmarrjes ndodh kur krijohen faktorë të rinj prodhimi, veçanërisht vende të reja pune.

Shkalla e lindshmërisë në ndërmarrje për një periudhë të caktuar referimi (zakonisht një vit kalendarik) është numri i lindjeve si përqindje e popullsisë së ndërmarrjeve aktive.

3. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Në fund të vitit 2022 në Shqipëri numërohen rreth 121 mijë biznese aktive, me përafërsisht 640 mijë persona të punësuar. Popullsia më e madhe e ndërmarrjeve aktive është lokalizuar në qarkun e Tiranës (57 mijë), e ndjekur nga qarku Durrës (13 mijë). Në qarkun Kukës dhe Gjirokastrë numërohen përafërsisht (1.3 mijë) dhe (2.4 mijë) ndërmarrje aktive.

Sikurse edhe në vitet e kaluara, sektori i shërbimeve është dominues në çdo qark duke u ndjekur nga industria.


Tabela 1. Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve dhe sektorëve të ekonomisë, 2022

Qarku	Gjithsej	Industria	Ndërtimi	Shërbimet
Berat	3.920	460	108	3.352
Dibër	2.114	296	90	1.728
Durrës	12.400	1.261	726	10.413
Elbasan	7.462	763	272	6.427
Fier	9.248	847	361	8.040
Gjirokastrë	2.398	263	82	2.053
Korçë	5.942	523	203	5.216
Kukës	1.271	122	55	1.094
Lezhë	4.101	323	254	3.524
Shkodër	6.044	496	236	5.312
Tiranë	56.487	3.329	3.260	49.898
Vlorë	9.207	646	588	7.973
Shqipëria	120.594	9.329	6.235	105.030

Burimi: INSTAT, Regjistrat e biznesit, 2022

Bizneset e reja gjatë vitit 2022 (15 mijë) krijuan afërsisht 32 mijë vende pune, bazuar në Regjistrat e Biznesit në fund të vitit 2022.

Figura 1 paraqet kontributin në punësim të ndërmarrjeve të reja të krijuara gjatë vitit 2022 sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë së vendit. Sektori i shërbimeve kontribuon me rreth 76,8% në krijimin e vendeve të reja të punës, e ndjekur nga industria me rreth 13,7% dhe ndërtimi me 9,5%.


Figura 1. Kontributi në punësim sipas sektorëve, viti 2022

Burimi: INSTAT, Regjistrat e biznesit, 2022

4. NDËRMARRJET AKTIVE NË EKONOMINË E BIZNESIT

Në vitin 2022, në nivel vendi, 87,1 % e të gjitha ndërmarrjeve aktive në ekonominë e biznesit³ janë brenda sektorit të shërbimeve, duke ofruar punë për mbi dy të tretat e numrit të përgjithshëm të personave të punësuar. Sektori i shërbimeve është dominues në çdo qark, si në numër ndërmarrje ashtu dhe në punësim.

Sektori i ndërtimit numëron vetëm 5,2 % të ndërmarrjeve aktive në Shqipëri me kontribut në punësim me 8.9 % të punësimit total.

Figura 2. Kontributi i bizneseve në vend sipas sektorëve të ekonomisë, 2022 (%)

Burimi: INSTAT, Regjistrat e biznesit, 2022

3. Sipas metodologjisë së Eurostat, statistikat e demografisë së biznesit përfshijnë aktivitetet sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike NVE Rev.2 (Seksionet B deri R, S95 dhe S96)

Kontributin më të madh në numrin e ndërmarrjeve të krijuara në ekonominë e biznesit si dhe në punësim, e kanë dhënë ndërmarrjet në aktivitetet: “Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave”, “Akomodimi dhe shërbimi ushqimor” si dhe “Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike”. Këto aktivitete së bashku përbëjnë pothuajse gjysmën e ndërmarrjeve të reja dhe punësimin krijuar në to.

Tabela 2. Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik, 2022

Aktiviteti ekonomik Seksioni		Gjithsej	nga të cilat Ndërmarrje të reja
Shqipëria		120.594	15.261
Industri		9.329	938
B	Industria nxjerrëse	760	23
C	Industria përpunuese	7.752	832
D	Energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	520	42
E	Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	297	41
Ndërtimi		6.235	1.099
F	Ndërtimi	6.235	1.099
Shërbimet		105.030	13.224
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	43.885	4.161
H	Transporti dhe magazinimi	6.046	658
I	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	17.452	1.960
J	Informacioni dhe komunikacioni	4.872	1.429
K	Aktivitete financiare dhe të sigurimit	1.225	233
L	Aktivitete të pasurive të paluajtshme (real estate)	1.510	438
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	9.323	1.535
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse	4.668	1.018
P	Arsimimi	1.380	127
Q	Shëndeti dhe aktivitete të punës sociale	4.626	495
R	Arte, argëtim dhe çlodhje	1.525	260
S95	Riparimi i kompjuterëve dhe artikujve personale dhe familjarë	3.006	184
S96	Aktivitetet e tjera shërbimi	5.512	726

Burimi: INSTAT, Regjistrat e biznesit, 2022

Ndërmarrjet industriale punësojnë mesatarisht 15 persona për ndërmarrje, krahasuar me një mesatare prej 9 personash për aktivitetin ekonomik “Ndërtim”. Numri mesatar i personave të punësuar në shërbime është më i ulët, mesatarisht 4 persona për ndërmarrje.

5. SHKALLA E LINDSHMËRISË

Lindja e ndërmarrjeve të reja shpesh shihet si një nga përcaktuesit kryesorë të krijimit të vendeve të punës dhe rritjes ekonomike. Ndërmarrjet e reja rrisin konkurrencën duke i detyruar ato të bëhen më efikase në funksion të konkurrencës së re. Si të tilla, ato stimulojnë inovacionin dhe lehtësojnë adoptimin e teknologjive të reja.

Gjatë vitit 2022 janë krijuar 15.261 ndërmarrje, nga të cilat 30% e tyre filluan aktivitetin ekonomik gjatë tremujorit të parë.

Në territorin e Shqipërisë ndërmarrjet me aktivitet tregtar zënë peshën kryesore si në total ekonomi, ashtu edhe në ndërmarrjet e reja.


Tabela 3 Lindshmëria e ndërmarrjeve sipas 3-mujorëve, 2022

Aktiviteti ekonomik		Viti 2022				
		Gjithsej	I	II	III	IV
B	Industria nxjerrëse	23	5	4	5	9
C	Industria përpunuese	832	256	172	193	211
D	Energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	42	10	7	8	17
E	Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	41	7	10	12	12
F	Ndërtimi	1.099	302	250	246	301
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorcikletave	4.161	1.248	1.074	855	984
H	Transporti dhe magazinimi	658	139	158	167	194
I	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	1.960	608	507	374	471
J	Informacioni dhe komunikacioni	1.429	439	392	293	305
K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	233	76	45	46	66
L	Aktivitetet të pasurive të paluajtshme (real estate)	438	142	97	123	76
M	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	1.535	499	378	338	320
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse	1.018	282	273	235	228
P	Arsimimi	127	42	22	40	23
Q	Shëndeti dhe aktivitetet të punës sociale	495	163	149	94	89
R	Arte, argëtim dhe çlodhje	260	90	55	56	59
S95	Riparimi i kompjuterave dhe artikujve personale dhe familjarë	184	67	46	30	41
S96	Aktivitetet të tjera shërbimi	726	197	184	151	194
Shqipëria		15.261	4.572	3.823	3.266	3.600

Burimi: INSTAT, Regjistrat e biznesit, 2022

Në vitin 2022, shkalla e lindshmërisë së ndërmarrjeve në Shqipëri është 12,7% (Figura 3). Numri i ndërmarrjeve të reja si përqindje e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive varion nga 7.4% në qarkun Gjirokastrë në 15.2% në qarkun Tiranë.


Figura 3. Shkalla e lindshmërisë sipas qarqeve, 2022 (%)



Burimi: INSTAT, Regjistrat e biznesit, 2022

Kontributi i ndërmarrjeve të reja në rang vendi është 5% të punësimit total. Ndërmarrjet e reja në qarkun Vlorë dhe Korçë japin një kontribut përkatësisht me 7,2 % dhe 6,0 % të punësimit në këto qarqe.

Figura 4 Kontributi i ndërmarrjeve të reja në punësim për çdo qark, 2022 (%)



Burimi: INSTAT, Regjistrat e biznesit, 2022

6. KONKLUZIONE

Si çdo ekonomi tjetër në botë, edhe ekonomia në Shqipëri bazohet më së shumti në aktivitetet e shërbimeve. Kjo qasje ndikon edhe në krijimin e bizneseve të reja dhe vendeve të reja të punës. Aktivitetet ekonomike “Tregtia” dhe “Akomodimi dhe shërbimi ushqimor” japin një kontribut domethënës në ekonominë e vendit.

Statistikat e demografisë së biznesit ndihmojnë politikë-bërësit, studiuesit dhe bizneset të kuptojnë faktorët që ndikojnë në krijimin, performancën dhe mbijetesën e ndërmarrjeve, si dhe të hartojnë dhe vlerësojnë politika dhe strategji për të nxitur sipërmarrjen, inovacionin dhe konkurrencën.

Roli i bizneseve të reja në stimulimin e rritjes ekonomike ka marrë vëmendje të shtuar me zhvillimin e jashtëzakonshëm të teknologjive të reja, të informacionit dhe komunikimit.

Bizneset e reja përveç se ofrojnë shumë vende pune, ofrojnë edhe produkte të reja duke plotësuar nevojat e konsumatorëve. Të tilla mund të përmendim: mirëmbajtjen e rrjeteve sociale, shitje online të produkteve dhe shërbime etj.

Statistikat e demografisë së biznesit dhe sipërmarrjes japin informacion për krijimin, mbijetesën dhe për karakteristikat dhe aktivitetet e bizneseve. Gjatë viteve të fundit, interesi për këto statistika është rritur pasi ato janë burime informacioni për inovacionin, konkurrencën, rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës. Kërkesa në rritje vë përpara përgjegjësisë INSTAT prodhimin e statistikave demografike të biznesit me cilësi të përshtatshme dhe burime të mira të dhënash.

Regjistrat statistikorë të biznesit, të cilët luajnë një rol qendror në prodhimin e statistikave ekonomike, ofrojnë infrastrukturën statistikore për prodhimin e demografisë së biznesit dhe statistikave të bizneseve të reja në formën e të dhënave të strukturuar për njësitet e biznesit dhe karakteristikave të tyre.

Lexuesi në këtë artikull informues u prezantua mbi situatën e disa prej ngjarjeve demografike të biznesit, bazuar tërësisht në informacionin që *Regjistrat e Biznesit* përmbajnë.

Prej vitesh INSTAT bashkëpunon me shumë efikasitet nëpërmjet memorandumeve me institucione si: *Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)*, *Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)* etj. Përgjatë viteve cilësia e burimit administrativ është përmirësuar ndjeshëm dhe kjo ka ndikuar direkt në përmirësimin e cilësisë së regjistrave të biznesit si shtylla kryesore e statistikave ekonomike pranë INSTAT.

REFERENCAT

1. Databaza statistikore e Regjistrave të Biznesit
[PxWeb - Select table \(instat.gov.al\)](#)
2. Publikimi i Regjistrave të Biznesit, 2022
[Regjistrat e Biznesit, 2022 | Instat](#)

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT DHE DIGJITALIZIMI NË SHQIPËRI

GERALD BRAHJA¹

Abstrakt

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është një fushë e studimit dhe përdorimit të teknologjisë në përparimin dhe ndryshimet e shoqërisë dhe ekonomisë. Digjitalizimi është një pjesë e rëndësishme e kësaj fushe dhe përfshin transformimin e informacionit dhe proceseve në formate dhe mjedise digjitale.

Përdorimi i TIK sot, është bërë domosdoshmëri dhe një aspekt shumë i rëndësishëm në zhvillimin e biznesit. Si rrjedhojë, digjitalizimi ka ndryshuar në mënyrë thelbësore ekonominë e shumë vendeve të botës.

Shërbimet digjitale për ndërmarrjet vazhdimisht janë pjesë e përditësimeve duke ofruar cilësi më të mirë si dhe duke inkurajuar bizneset që gjithnjë e më shumë të kalojnë drejt metodave të digjitalizuara të modeleve të sipërmarrjes. Ritmi i ndryshimeve që vijnë si rezultat i teknologjive të reja digjitale është në rritje të pandalshme për shkak të mundësisë për të ulur kostot dhe rritur produktivitetin.

Ky artikull ka për qëllim të analizojë se si përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe procesi i digjitalizimit kanë ndikuar në bizneset të natyrave të ndryshme, dhe si ato kanë shfrytëzuar këto zhvillime për të përmirësuar efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e tyre. Duke pasqyruar përparimin e teknologjisë dhe ndryshimet në mënyrën se si bizneset operojnë dhe komunikojnë, ky studim gjithashtu do të ofrojë një pasqyrë se si bizneset janë përgatitur për sfidat dhe mundësitë që dalin nga këto ndryshime teknologjike në të ardhmen.

Fjalë kyçe:

Tik, Ndërmarrje, Software, Biznes

1. Instituti i Statistikave, gbrahja@instat.gov.al

1. HYRJE

Biznesi elektronik është forma bashkëkohore e organizimit, e cila në masë të madhe varet nga përdorimi i teknologjisë dhe mbështetja e sistemeve informatike. Digjitalizimi i shërbimeve nënkupton zëvendësimin e proceseve manuale me ato digjitale për t'iu ofruar bizneseve dhe klientëve shërbime më të shpejta, të lehta dhe më cilësore si dhe për ti dhënë bizneseve një avantazh konkurues në treg.

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit, jo vetëm që ka ndryshuar tregun, por gjithashtu ka ndryshuar edhe rëndësinë e shumë faktorëve kyç të të bërit biznes. Përdorimi i internetit ka ndikuar në riorganizimin e tregut dhe ndërmarrjeve duke ju imponuar këtyre të fundit në përdorimin e rrjeteve sociale e aplikacioneve të ndryshme online për reduktimin e kostove dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore.

Një numër i lartë aplikacionesh software përdoren nga ndërmarrjet për përpunimin e informacionit e cila përdoret për planifikimin dhe menaxhimin e burimeve të ndërmarrjeve, duke ndarë informacionet midis fushave të ndryshme funksionale (p.sh. kontabilitet, planifikim, prodhim, marketing, etj). Përdorimi i internetit është rritur në mënyrë eksponenciale për ndërmarrjet, pasi u mundëson firmave të zgjerojnë praninë e tyre dhe për ti shërbyer një tregu më të madh apo dhe për të shitur mallra dhe shërbime tërësisht online.

2. METODOLOGJIA

INSTAT për matjen e nivelit të treguesve të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka kryer ndër vite vërtetimin mbi “Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit” pranë ndërmarrjeve ekonomike me 10 e më shumë të punësuar. Grumbullimi i të dhënave realizohet me metodën CAPI nëpërmjet intervistës ballë për ballë me tablet. Metodologjia e ndjekur dhe pyetsori i përdorur është në përputhje me rregulloren e Këshillit Europian. Termi “Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)” i referohet teknologjive që sigurojnë akses në informacione përmes telekomunikimit. Termi TIK është i ngjashëm me termin Teknologji Informacioni (TI), por fokusohet në teknologjitë e komunikimit që përfshijnë internetin, rrjetin, celularët dhe media të tjera komunikimi. Qëllimi i vërtetimit “Anketa për Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit” është të mbledhë dhe shpërndajë informacion të harmonizuar dhe të krahasueshëm për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në ndërmarrje. Për matjen e përdorimit të TIK, në vitin 2023 INSTAT ka intervistuar 2,067 ndërmarrje të të gjitha formave ligjore dhe llojeve të pronësisë me 10 e më shumë të punësuar. Njësia e vërtetimit është ndërmarrja, e rezultuar aktive nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve.

3. NDIKIMI I TIK DHE DIGJITALIZIMI NË EKONOMI, ZBATIMI I TEKNOLOGJISË SË SOFTWAREVE NË NDMARRJE

Kompanitë të cilat operojnë në Shqipëri janë pjesë e një tranzicioni teknologjik të vazhdueshëm, si pasojë një numër i lartë i tyre kanë përdorur software të ndryshëm për të maksimizuar fitimet (që është gjithashtu qëllimi kryesor i çdo biznesi), për të pasur një qasje më të lehtë tek klienti edhe tek furnitorët.

Për të kuptuar nivelin e përdorimit të TIK, vitet e fundit janë kryer vërtetime vjetore në ndërmarrje, në Republikën e Shqipërisë. Këto ndërmarrje i përkasin sektorëve të ndryshëm dhe klasifikohen sipas madhësisë bazuar në numrin e të punësuarve.

INSTAT ka publikuar statistika lidhur me përdorimin e TIK në ndërmarrje duke filluar nga viti 2015. Tabela më poshtë paraqet përqindjen e ndërmarrjeve që kanë akses në internet për serinë kohore, 2015-2023.

Tabela 1. Përqindja e ndërmarrjeve që kanë akses në internet

Madhësia e ndërmarrjes	Ndërmarrje që kanë akses në internet (10+)								
	Enterprises with internet acces (10+)								
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Gjithsej	96,2	96,8	96,9	97,5	97,8	98,2	98,4	98,7	99,1
10-49 të punësuar	95,5	96,1	96,6	97,5	97,3	97,8	98,0	98,4	99,0
50-249 të punësuar	98,6	100,0	98,1	99,5	99,9	99,5	100,0	100,0	99,2
250+ të punësuar	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0


Burimi: INSTAT, Përdorimi I Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje, 2023

Ajo që vihet re ndër vite është zhvillimi që kanë pësuar kompanitë në krijimin e kushteve dhe përshtatjes ndaj tregut, duke bërë të mundur implementimin e teknologjisë dhe përdorimin e internetit në ndërmarrje. Gjithashtu nga vërtetimi vihet re se ndërmarrjet e mëdha me më shumë se 50 punonjës, kanë plotësisht akses në internet.

Shumica e kompanive në mjedisin e biznesit kanë zbatuar disa forma të teknologjisë së internetit. Një tipar i rëndësishëm i e-biznes është aftësia për të komunikuar dhe për të transferuar informacion nëpërmjet internetit. Shumë kompani përdorin serverat e-mail që lejojnë menaxherët dhe punonjësit të dërgojnë mesazhe të brendshme ose informacione përmes komunikimit me e-mail. Kompanitë gjithashtu kanë zhvilluar faqet e internetit të biznesit që i lejojnë konsumatorët të rishikojnë informacionin rreth kompanisë dhe produkteve të saj para se të bëjnë blerje.

Këto faqe ofrojnë edhe për konsumatorët një mjet për të komunikuar me kompaninë. Figura më poshtë paraqet përqindjen e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike të cilat kanë faqe interneti.

Figura 1. Përqindja e ndërmarrjeve që kanë faqe interneti, sipas aktivitetit ekonomik, 2022-2023



Burimi: INSTAT, Përdorimi I Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje, 2023

Në kompanitë e mëdha të konsoliduara, teknologjia dhe interneti janë baza e çdo procesi pune, duke transformuar mënyrën se si këto kompani kryejnë biznes. Teknologjia i lejon bizneset të automatizojnë operacionet manuale dhe të përpunojnë informacione shumë më shpejt. Tregu i shitjeve online gjithashtu ka një rol të rëndësishëm në aktivitetin ekonomik të ndërmarrjeve të cilët operojnë në vend. Kjo metodë e re e biznesit shpesh përdoret përmes kompjuterave personalë, sistemeve të magazinimit të serverave dhe sistemeve të shitjes me pakicë ose regjistrave të cash-it, ndërsa interneti ka krijuar forma të reja të komunikimit dhe metoda të tjera të biznesit që përdorin kompanitë gjatë përpunimit të informacionit financiar.

Gjatë zhvillimit të teknologjisë dhe rritjes së përdorimit të internetit nga përdoruesit është zhvilluar shumë dhe tregu i shitjeve të produkteve online nga ndërmarrjet në vend. Siç vihet re dhe në tabelën më poshtë vit pas viti vërehet një rritje e produkteve dhe shërbimeve të cilat mund të blihen online.

Tabela 2. Përqindja e ndërmarrjeve që shesin produkte/shërbime online

Madhësia e ndërmarrjes	Ndërmarrje që shesin produkte/shërbime online (10+)								
	Enterprises that did e-commerce sales (10+)								
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Gjithsej	8,8	7,1	7,7	5,6	5,8	12,8	13,3	13,8	14,8
10-49 të punësuar	9,2	6,7	6,4	4,6	5,0	11,9	12,5	12,6	12,9
50-249 të punësuar	7,3	6,4	13,3	9,0	8,2	14,5	16,2	18,8	18,8
250+ të punësuar	7,4	9,7	12,9	16,9	15,1	19,7	23,5	18,2	18,8

Burimi: INSTAT, Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje, 2023


Digjitalizimi ka krijuar mënyra të tjera të shitjeve, vetëm duke përdorur një smartphone ose kompjuterin njerëzit mund të bëjnë blerje në çdo moment pa qënë nevoja të jenë prezent në dyqane. Globalizimi i mallrave dhe shërbimeve ka ndikur edhe në vendimarrjet e kompanive që operojnë në vendin tonë duke i orientuar drejt përparimit teknologjik.

Në ndërmarrjet Shqiptare vihet re përdorimi i CRM (Customer Relationship Management) një aplikacion software për menaxhimin e informacionit rreth klientëve të biznesit që përbëhet nga një metodologji menaxhimi, për vendosjen e klientit në qendër të aktivitetit të biznesit. Ky aplikacion bazohet në përdorimin e teknologjive të informacionit për të mbledhur, integruar, përpunuar dhe analizuar informacionin që lidhet me klientët. Gjithashtu përdoret dhe aplikacioni ERP (Enterprise Resource Planning) software i cili përdoret për planifikimin dhe menaxhimin e burimeve të ndërmarrjes, duke ndarë informacionet midis fushave të ndryshme. Këto software po implementohen nga një numër i madh ndërmarrjesh në Shqipëri.

Një aspekt tjetër i digjitalizimit të ekonomisë Shqiptare janë edhe investimet e kryera nga kompanitë në shërbimet Cloud, të cilat i referohen shërbimeve që përdoren në internet për të aksesuar programe kompjuterike nga çdo kompjuter, telefon personal, iPad, tablet etj.

Figura më poshtë paraqet përqindjen e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike të cilat përdorin shërbime Cloud.

Figura 2. Përqindja e ndërmarrjeve që përdorin shërbime Cloud.



Burimi: INSTAT, Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje, 2023

Shërbimet Cloud janë dizenuar për të mundësuar akses të lirë dhe të thjeshtë në burimet e informacioneve dhe aplikacionet e kompanisë, pa pasur nevojë për të ngritur një infrastrukturë të brendshme ose paisje teknologjike ekstra. Ajo që vihet re nga figura më sipër është se ndërmarrjet me aktivitet ekonomik në fushën e IT kanë investuar më shumë në përdorimin e shërbimeve Cloud.

4. KONKLUSIONE

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit ka ndryshuar disa funksione tradicionale të të bërit biznes, dhe në të njëjtën kohë ka ndikuar në ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun Shqiptar. Teknologjia e Informacionit dhe komunikimit 'TIK' konsiderohet në mbarë botën si një factor kyç për rritjen ekonomike, sektori i TIK në Shqipëri është në rritje të vazhdueshme. Ky zhvillim i shërbimeve digjitale dhe krijimi i platformave teknologjike duhet të jenë në koherencë me vendet më të zhvilluara të Bashkimit European.

Nga rezultatet e këtij studimi mund të konkludohet se në përgjithësi ndërmarrjet ofrojnë diversitet të shërbimeve digjitale dhe po ndjekin tendencën e shoqërive bashkëkohore në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Ndërmarrjet e vrojtura vlerësojnë se këto shërbime ndikojnë sidomos në kursimin e kohës dhe në uljen e kostos dhe shpenzimeve.

REFERENCA

1. INSTAT, Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje, 2023
<https://www.instat.gov.al/al/temat/shkenc%C3%AB-teknologji-dhe-inovacion/informacioni-dhe-teknologjit%C3%AB-e-komunikimit-n%C3%AB-nd%C3%ABrmarrje/>
2. OECD, Meeting of the OECD , Seizing the benefits of ICT.
<https://www.oecd.org/sti/2507572.pdf>

ECURIA E NDËRMARRJEVE TË HUAJA DHE TË PËRBASHKËTA NË SHQIPËRI

ELVIS MYFTARI¹

BRENDON TOMINI²

Abstrakt

Artikulli ka për qëllim të studiojë ecurinë e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta që operojnë në Shqipëri, të ndara sipas llojit të pronësisë, vendeve të origjinës, aktivitetit kryesor ekonomik dhe madhësisë së tyre. Statistikat mbi ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta synojnë të tregojnë ecurinë ndër vite të numrit të ndërmarrjeve që operojnë në territorin e Shqipërisë, strukturën ekonomike dhe strukturën e madhësisë së ndërmarrjes, sipas numrit të të punësuarve.

Gjithashtu, nëpërmjet këtyre statistikave sigurohet informacion mbi investimet e huaja të kryera në Shqipëri dhe tregtinë e mallrave, sipas vendeve të origjinës, veprimtarisë ekonomike dhe madhësisë së ndërmarrjeve.

Fjalë kyçe:

Ndërmarrja, Numri i të punësuarve, Investimet, Shitjet neto, Aktiviteti ekonomik, Vendi i origjinës.

1. Instituti i Statistikave, emyftari@instat.gov.al

2. Instituti i Statistikave, btomini@instat.gov.al

1. HYRJJE

Në këtë studim “Ecuria e Ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në Shqipëri”, të dhënat statistikore i referohen vitit 2022. Studimi përbëhet nga katër seksione.

- Seksioni i parë, jep informacion mbi aktivitetin ekonomik, duke treguar numrin gjithsej të ndërmarrjeve dhe duke i grupuar sipas llojit të pronësisë, në të huaja dhe të përbashkëta, si dhe duke pasqyruar ndryshimin e numrit të ndërmarrjeve, gjatë viteve të fundit.
- Seksioni i dytë, shpreh shpërndarjen e ndërmarrjeve me pronësi apo bashkëpronësi të huaj, sipas aktivitetit ekonomik.
- Seksioni i tretë, tregon strukturën e ndërmarrjeve sipas madhësisë së tyre.
- Seksioni i katërt përmban informacion mbi ndërmarrjet sipas shtetit të origjinës duke treguar shpërndarjen e ndërmarrjeve sipas shteteve.

Statistikat mbi ndërmarrjet private të huaja dhe të përbashkëta, synojnë të monitorojnë situatën, strukturën, intensitetin e tregtisë dhe performancën e tyre brenda territorit shqiptar, për vitin 2022.

Gjetjet kryesore të këtij materiali tregojnë se gjatë vitit 2022, ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta, kanë punësuar mesatarisht 12.5% të punësuarve gjithsej.

Ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët, gjatë vitit 2022 përfaqësojnë 5,3 % të numrit të ndërmarrjeve gjithsej në vend.

2. METODOLOGJIA

Për llogaritjen e këtyre statistikave bëhet lidhja ndërmjet skedarit të statistikave të industrisë, tregtisë dhe shërbimeve me Regjistrin e Ndërmarrjeve. Meqenëse përditësimi i Regjistrit të Ndërmarrjeve është me frekuencë vjetore, të gjitha llogaritjet e tregueseve bëhen në bazë vjetore.

2.1 Variablat

Ndërmarrja është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Numri i të punësuarve përfshin të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshire pronarët, të punësuarit me pagese si dhe pjestarët e familjes të paguar.

Investimet gjatë periudhës referuese përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjatë të blera prej ndërmarrjeve ose të krijuara për llogari të vet me qëllim përdorimi për një periudhë jo më të vogël se 1 vit në procesin e prodhimit, përfshirë tokën.

Shitjet neto përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësi që vërohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me vlerën e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar. Ky variabël mund të gjendet në botimet e tjera me termat: shifra e afarizmit ose xhiro.

Aktiviteti ekonomik ndodh kur burime të tilla si mallrat kapitale, puna, teknikat e prodhimit ose produktet ndërmjetës janë të kombinuara për të prodhuar mallra ose shërbime specifike. Kështu, një aktivitet ekonomik është i karakterizuar nga një kontribut i burimeve, një proces të prodhimit dhe një prodhim të produkteve (mallra ose shërbime).

3. AKTIVITETI EKONOMIK I NDËRMARRJEVE TË HUAJA DHE TË PËRBASHKËTA

Gjatë vitit 2022, ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë të huaj zënë 5,3% të ndërmarrjeve gjithsej, krahasuar me 5,6% të ndërmarrjeve aktive, në vitin 2021 dhe punësojnë 12,5% të të punësuarve gjithsej. Ndërmarrjet nga vendet Bashkimit Evropian përfaqësojnë 62,7% të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta.

Pronarët apo bashkëpronarët me origjinë italiane dhe greke përfaqësojnë 48,8% të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta gjithsej.


Ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta janë përqendruar kryesisht në bashkitë Tiranë dhe Durrës, përkatësisht 70,7% dhe 11,5%.

Tabela 1. Aktivitetet ekonomike të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta

Aktiviteti Ekonomik	Gjithsej	Shqiptare	Të huaja	Të përbashkëta
Gjithsej	125.222	118.633	4.934	1.655
Prodhuesit e të mirave	16.942	15.475	991	476
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	1.385	1.321	38	26
Industria	9.322	8.443	561	318
Ndërtimi	6.235	5.711	392	132
Prodhuesit e shërbimeve	108.280	103.158	3.943	1.179
Tregtia	43.885	42.361	1.096	428
Transporti dhe magazinimi	6.046	5.901	105	40
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	17.452	17.159	216	77
Informacioni dhe komunikacioni	4.872	4.292	480	100
Shërbime të tjera	36.025	33.445	2.046	534

Burimi: INSTAT, Regjistri i Biznesit 2022

Gjatë viteve të fundit ka pasur një rritje të prezencës së tyre në ekonominë shqiptare. Numri i ndërmarrjeve të huaja 2 vitet e fundit ka pasur një rritje duke kaluar dhe vitet e para pandemisë globale. Aktualisht, në Republikën e Shqipërisë, operojnë 6,589 ndërmarrje të huaja dhe të përbashkëta, duke pësuar një ulje të lehtë të numrit krahasuar me vitin 2021, që operonin 6,635 ndërmarrje. Në vitin 2020 numri i ndërmarrjeve ishte 6,035 duke kapur numrin më të ulët të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në Shqipëri.

Figura 1. Numrit i ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta gjatë viteve 2018-2022

Burimi: INSTAT

4. AKTIVITETI EKONOMIK I NDËRMARRJEVE TË HUAJA DHE TË PËRBASHKËTA

Aktiviteti ekonomik që ndërmarrja kryen është një tregues mjaft i rëndësishëm për të grupuar dhe sektorin ku ato operojnë, në prodhues apo shërbime.

Tabela 2 paraqet shpërndarjen e ndërmarrjeve me pronësi apo bashkëpronësi të huaj, sipas aktivitetit ekonomik. Në vitin 2022, aktivitetet “Tregti”, “Shërbime të tjera” si dhe “Industri” janë aktivitetet ku këto ndërmarrje janë më prezentë në ekonominë Shqiptare, duke zënë një përqindje të konsiderueshme, përkatësisht me 75,6% ndaj ndërmarrjeve me pronarë dhe bashkëpronarë të huaj gjithsej.

Gjatë vitit 2022, 77,7% e ndërmarrjeve me pronarë dhe bashkëpronarë të huaj operojnë në sektorët e prodhimit të shërbimit dhe vetëm 22,3 % e tyre operojnë në sektorët e prodhimit të të mirave.

Tabela 2. Aktivitetet ekonomike të ndermarrjeve me origjine te shteteve te BE-së dhe shteteve jashtë BE-së

Gjendje në fund të vitit 2022			
Aktiviteti Ekonomik	Gjithsej	Shtetet e BE-së	Shtetet e jashtë BE-së
Gjithsej	6.589	4.130	2.459
Prodhuesit e të mirave	1.467	985	482
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	64	44	20
Industria	879	658	221
Ndërtimi	524	283	241
Prodhuesit e shërbimeve	5.122	3.145	1.977
Tregtia	1.524	858	666
Transporti dhe magazinimi	145	76	69
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	293	118	175
Informacioni dhe komunikacioni	580	369	211
Shërbime të tjera	2.580	1.724	856

Burimi: INSTAT, Regjistri i Biznesit 2022

5. NDËRMARRJET SIPAS MADHËSISË SË TYRE

Për vitin 2022, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme zënë 95,4% të bizneseve në vend. Ndërmarrjet me 50 ose më shumë të punësuar, përfaqësojnë gjithsej 4,6% të ndërmarrjeve në Shqipëri, për vitin 2022. Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar dukshëm zënë një përqindje të vogël në numër, por kontributi i tyre në punësim është i madh.

Duke ju referuar tabelës 3, të grupuar sipas numrit të të punësuarve nga 6,589 ndërmarrje të huaja dhe të përbas-hkëta nga të cilat 4,130 janë pjesë e BE-së dhe 2,459 shtete që nuk janë pjesë e BE-së, në të cilën numrin më të madh e zënë ndërmarrjet me 1-4 të punësuar me 5,132 ndërmarrje, 486 janë nga ndërmarrjet me 5-9 të punësuar, nga ndërmarrjet me 10-49 të punësuar bëjnë pjesë 667 ndërmarrje dhe tek ndërmarrjet e mesme 50+ janë gjithsej 304 ndërmarrje.

Tabela 3. Ndërmarrjet sipas numrit të punësuarve

Grupuar sipas numrit të të punësuarve	Gjithsej	Shtetet e BE-së	Shtetet e jashtë BE-së
Gjithsej	6.589	4.130	2.459
1-4	5.132	3.164	1.968
5-9	486	296	190
10-49	667	438	229
50+	304	232	72

Burimi: INSTAT, Regjistri i biznesit 2022

Duke ju referuar tabelës 4, nga 6,589 ndërmarrje të huaja dhe të përbashkëta, 4,934 prej tyre janë në pronësi 100% të pronarëve me shtetësi të huaj dhe 1,655 ndërmarrje janë me pronësi shqiptare dhe të huaj. Nga 1,655 ndërmarrje me pronësi të përbashkët, 942 prej tyre, pjesa më e madhe e aksioneve mbizotërohet nga aksionerë me shtetësi të huaj dhe 713 ndërmarrje mbizotërohet nga aksionerë me shtetësi shqiptare.

Tabela 4. Ndërmarrjet aktive të huaja dhe të përbashkëta

Grupuar sipas zotërimit	Gjithsej	Shtetet e BE-së	Shtetet e jashtë BE-së
Gjithsej	6.589	4.130	2.459
Të huaja 100%	4934	3.043	1.968
Të përbashkëta	1655	1087	568
<i>nga të cilat</i>			
Mbizotërim Shqiptar	713	478	235
Mbizotërim i Huaj	942	609	333

Burimi: INSTAT, Regjistri i biznesit 2022

6. NDËRMARRJET SIPAS SHTETIT TË ORIGINËS

Pronarët apo bashkëpronarët me origjinë italiane përfaqësojnë 42,7% të ndërmarrjeve me origjinë të huaj, gjithsej. Në një raport të konsiderueshëm, prezentë në ekonominë shqiptare janë dhe ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë me origjinë nga vendet e rajonit si: Kosova, Greqia dhe Turqia, por dhe nga vendet perëndimore si Gjermania dhe SH.B.A. Në tabelën 4 do të gjeni ndërmarrjet e grupuara sipas numrit të të punësuarve.

Tabela 5. Ndërmarrjet sipas shteteve të grupuara sipas numrit të të punësuarve

Shtetet	Gjithsej	Grupuar sipas numrit të të punësuarve			
		1-4	5-9	10-49	50+
Gjithsej	6.589	5.132	486	667	304
Italia	2.815	2.722	161	289	153
Greqia	341	235	42	45	19
Kosova	460	365	51	36	8
Turqia	341	258	29	36	18
Gjermania	246	174	23	38	11
Maqedonia e Veriut	142	107	19		
Izraeli	52	40	2		
SH.B.A.	167	124	8	27	8
Të tjerat	1.965	1.557	151	176	81

Burimi: INSTAT, Regjistri i biznesit 2022

7. KONKLuzionet

Ndërmarrjet me pronësi të huaj dhe të përbashkët përfaqësojnë 5,3 % të numrit të ndërmarrjeve gjithsej në vend.

Numri i ndërmarrjeve të huaja 2 vitet e fundit ka pasur një rritje duke kaluar dhe vitet e para të Covidit.

Kryesisht ndërmarrjet me pronarë dhe bashkëpronarë të huaj janë më prezent në sektorët e prodhimit të shërbimeve me 77,7 % kundrejt sektorëve të prodhimit të mirave me 22,3 %.

95,4% të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta që kryejnë aktivitet në Shqipëri klasifikohen si ndërmarrje të vogla dhe të mesme, sipas strukturës së të punësuarve.

Vetëm 4,6% të ndërmarrjeve gjithsej, në Shqipëri, për vitin 2022 klasifikohen si ndërmarrje të mëdha, sipas strukturës së të punësuarve. Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar zënë një përqindje të vogël në numër, por kontributi i tyre në punësim është i madh.

Pronarët apo bashkëpronarët me origjinë italiane, përfaqësojnë 42,7% të totalit të ndërmarrjeve me origjinë të huaj. Prezentë në ekonomine shqiptare, në një raport të konsiderueshëm, janë dhe ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë me origjinë nga vendet e rajonit: si Kosova, Greqia dhe Turqia, por dhe nga vendet perëndimore si Gjermania dhe SH.B.A.

REFERENCAT

1. Regjistrat e biznesit 2022 Instat

<https://www.instat.gov.al/media/11652/regjistrat-e-biznesit-2022.pdf>

2. Industria, tregtia dhe shërbimet/ regjistrat e biznesit 2022

https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/regjistrat-e-biznesit/#tab2As_nonem_autae_Nam_audicitatem_es_as_mi_corio_elessit_quae_pa_volorrum_ent_ratios_aperio_blaut_il_est_iunt_aute_estrum_id_ut_quam_sam_dis_inum_es



INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

INFOSTAT
📈📍🌐

REVISTË INFORMATIVE
NR. 04